



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 701 Akti

Nr. 709 Vendimi

Tiranë, më 26.10.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Valbona Sanxhaktari	Kryesuese
Olsi Komici	Relator
Firdes Shuli	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Resilda Bilaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në datën 23.10.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Anila Bebeçi**, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/ b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, komisionerin Olsi Komici, subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, z. Steven Kessler, si pasi shqyrtoi në seancë dëgjimore publike, në tërësinë e tij vlerësimin kalimtar ndaj subjektit të rivlerësimit Anila Bebeçi, e cila kërkoi konfirmimin e saj në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

- 1.** Subjekti i rivlerësimit, znj. Anila Bebeçi, ushtron detyrën e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, që nga muaji shkurt i vitit 1994 dhe në bazë të nenit 179/b/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.
- 2.** Subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar me shortin e datës 15.12.2020, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, short nga i cili rezultoi trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Valbona Sanxhaktari, Olsi Komici relator dhe Firdes Shuli.
- 3.** Me vendimin e datës 15.1.2021, trupi gjykues vendosi të zgjedhë kryesues të trupit gjykues komisioneren Valbona Sanxhaktari, si dhe ka vendosur fillimin e hetimeve për subjektin e rivlerësimit sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimi pasurisë; kontrolli i figurës; vlerësimi i aftësive profesionale.
- 4.** Me *email*-in e datës 21.1.2021, subjekti i rivlerësimit u njoftua për fillimin e hetimit dhe përbërjen e trupit gjykues, si dhe në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit u deklarua mungesa e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues.
- 5.** Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni) janë administruar raportet e hartuara nga institucionet ndihmëse: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK); Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP), si dhe informacionet nga institucione të tjera publike e private, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për të tria kriteret e vlerësimit.
- 6.** Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, në datën 29.9.2023 vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit bazuar në të tria kriteret, si dhe njoftimin e saj për t’u njohur me dosjen dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.
- 7.** Subjekti u njoftua me *email*-in e datës 5.10.2023 me rezultatet e hetimit, me të drejtën për t’u njohur me materialet e dosjes, për të paraqitur pretendime/sqarime shtesë apo për të kërkuar marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e përfutuara nga hetimi kryesisht i zhvilluar nga Komisioni.

8. Pasi u njoh me rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në datën 19.10.2023 pranë zyrës së protokollit të Komisionit prapësimet dhe provat në lidhje me rezultatet e hetimit.

9. Komisioni, bazuar në vendimin datë 19.10.2023, nëpërmjet *email*-it të datës 19.10.2023 i njoftoi subjektin ftesën për seancën dëgjimore të datës 23.10.2023 (ora 10:00).

II. SEANCA DËGJIMORE

10. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 23.10.2023 (ora 10:00) në Sallën e Konferencave, Pallati i Koncerteve, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler.

11. Në këtë seancë subjekti u paraqit personalisht dhe në përfundim kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

12. Znj. Anila Bebeçi ka qenë bashkëpunuese gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur kur i është kërkuar sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 dhe duke respektuar afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

13. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b, Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit anëtarët e Komisionit vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo *indicie* në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes, duke vlerësuar edhe hetimin e kryer nga organet e tjera ndihmëse, por pa u ndikuar nga konstatimet përfundimtare të tyre.

14. Për subjektin e rivlerësimit Anila Bebeçi, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të saj, si dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit përfshin tri kritere: vlerësimin e pasurisë; kontrollin e figurës; vlerësimin e aftësive profesionale.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

15. ILDKPKI-ja ka hartuar dhe ka dërguar raportin përkatës¹ pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Anila Bebeçi, e cila është subjekt deklarues pranë këtij institucioni që prej vitit 2003, me nr. indeksi ***. Në përfundim të veprimeve verifikuese, ILDKPKI-ja ka konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje pasurie;*

¹ Raporti nr. ***, datë 6.12.2018, nga ILDKPKI-ja, për subjektin e rivlerësimit Anila Bebeçi.

- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

16. Komisioni vëren se bazuar në nenin 31/1² të ligjit nr. 84/2016, subjekti Anila Bebeçi ka dorëzuar deklaratën e pasurisë (shtojca nr. 2, deklarata *Vetting*) në datën 20.1.2017, brenda afatit 30-ditor nga hyrja e ligjit në fuqi³. Pas analizimit të kësaj deklarate, raportit dhe dosjes së dërguar nga ILDKPKI-ja, si dhe informacioneve të marra nga subjekte të së drejtës publike e private, bazuar në nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me pasuritë e deklaruara në deklaratën *Vetting* nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, nga hetimi rezultuan të deklaruara në deklaratën *Vetting* pasuritë si vijon:

Pasuri të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit

1. Shtëpi banimi në Lagjen nr. ***, Durrës, p. ***, ap. ***, kati ***, me sipërfaqe 108.8 m², sipas kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.9.2007, të noterisë Durrës, blerë në vlerën 5,000,000 lekë.

Burimi i krijimit: “Shitja e shtëpisë në Lagjen nr. ***, Durrës dhe në muajin gusht 2007 i kam marrë hua motrës time M. L. në shumën 10,000 euro dhe kunatit tim M. Rr. në shumën 500,000 lekë. Kjo e vërtetuar edhe me deklaratën noteriale datë 21.7.2016, para noterit Durrës, me nr. *** rep., nr. *** kol. Pjesa takuese: 50%. (Kjo pasuri është deklaruar edhe nga bashkëshorti i subjektit në deklaratën *Vetting*).

Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

1.1 Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar blerjen e kësaj pasurie që në DIPP-në e vitit 2007 (të dorëzuar në datën 5.3.2008).

1.2 Në DIPP-në e vitit 2007 (korrigjuar në datën 23.7.2008⁴), subjekti, përveç blerjes së këtij apartamenti ka deklaruar edhe burimet e krijimit të tij: (i) shitja e apartamentit 1+1 me sip. 59.38 m², në Lagjen nr. ***, rruga “****”, Durrës, në datën 22.8.2007, me vlerë 1,900,000 lekë; (ii) kursimet *cash* 800,000 lekë deri në datën 31.12.2006, pakësuar gjendja *cash* për blerjen e apartamentit. Vlera: 300,000 lekë. Pjesa takuese: 100%; (iii) dy hua pa afat dhe pa interes që ka marrë në gusht të vitit 2007, në vlerën 10,000 euro, nga personi fizik “M. L.” (motra e saj, me profesion stomatologe) dhe në vlerën 500,000 lekë nga personi fizik “M. Rr.” (bashkëshorti i motrës së saj A. Rr., me profesion noter). Në deklarim subjekti sqaron se huamarrjet nuk i ka deklaruar në momentin e dorëzimit të deklaratës, pasi ka menduar se meqë ua ka marrë motrave dhe pa kontratë noteriale nuk duheshin deklaruar⁵.

² Subjekti i rivlerësimit ka detyrimin të plotësojë deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon atë pranë ILDKPKI-së.

³ Referuar parashikimit kushtetues të nenit 84/3, datës së miratimit të ligjit nga Parlamenti, datës të botimit të ligjit në Fletoren Zyrtare³, si dhe vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, ligji hyri në fuqi në datën 8.10.2016. Në datën 25.10.2016, ligji u pezullua nga Gjykata Kushtetuese. Për këtë arsye, afati i zbatimit të ligjit eci deri në 19 janar 2017. Në datën 18.1.2017, Gjykata Kushtetuese rrëzoi kërkesën për shfuqizimin e ligjit. Ky vendim u botua në Fletoren Zyrtare në datën 19.1.2017. Si rezultat, afati 30-ditor në dispozicion të subjekteve të rivlerësimit për dorëzimin e deklaratës së pasurisë ka përfunduar në datën 31.1.2017.

⁴ Korrigjuar me procesverbalin e datës 23.7.2008 në ILDKPKI, për sqarimin dhe plotësimin e burimit të krijimit të shtëpisë së blerë në vitin 2007.

⁵ Në ILDKPKI, sipas procesverbalit datë 8.7.2016, subjekti ka shpjeguar se huat i ka marrë nga motrat e saj M. L. dhe A. Rr., me qëllim për të mos marrë kredi bankare për shkak të interesave të larta.

1.3 Subjekti ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2008 shlyerjen e shumës 500,000 lekë, që i kishte marrë hua kunatit të saj M. Rr. dhe shlyerjen e shumës 3,000 euro, që i kishte marrë hua motrës M. L., ndërsa shumën 7,000 euro, që i mbeti si detyrim i pashlyer motrës, e ka deklaruar si detyrim të shlyer në DIPP-në e vitit 2009.

1.4 Subjekti, ndër të tjera, i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*: (i) kontratë shitblerjeje⁶ datë 11.9.2007, ku shitësit A. B. e P. B. i shesin shtetasve E. dhe A. B. apartamentin e banimit nr. ***, me sip. 108.8 m², k. ***, shk. ***, p. ***, në Lagjen nr. ***, rruga “****”, Durrës, kundrejt çmimit 5,000,000 lekë, paguar *cash* në prani të noterit; (ii) certifikatë pronësie datë 24.9.2007, e apartamentit me nr. pasurie ***, në emër të shtetasve E. dhe Anila Bebeçi; (iii) procesverbal datë 23.7.2008, i ILDKPKI-së, bashkëlidhur DIPP-së së vitit 2007, ku subjekti ka sqaruar dhe plotësuar burimin e krijimit të këtij apartamenti; (iv) deklaratë noteriale⁷ datë 21.7.2016, ku shtetasit Anila Bebeçi, M. L. e M. Rr. deklarojnë se Anila Bebeçi ka marrë nga M. L. huan prej 10,000 euro dhe nga M. Rr. huan prej 500,000 lekësh për blerjen e këtij apartamenti dhe, më pas, me të ardhurat nga puna e subjektit të rivlerësimit, bashkëshortit dhe djalit të saj është mundësuar kthimi i huave me këste deri në shlyerjen e plotë të tyre dhe aktualisht nuk ka asnjë detyrim ndaj huadhënësve.

1.5 Komisioni vëren se sipas çmimit referencë⁸ të EKB-së (81,080 lekë/m²) për blerjen e apartamenteve në vitin 2007, në qytetin e Durrësit, subjekti i rivlerësimit e ka blerë apartamentin 3,821,504 lekë (ose 43%) më lirë se çmimi referencë dhe, për këtë arsye, Komisioni hetoi për ndonjë situatë konflikti interesi midis subjektit të rivlerësimit dhe shtetasve A. dhe P. B., por nga hetimi nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë⁹. Nga ana tjetër, nga informacionet publike mediatike rezulton se shtetasi A. B. është arrestuar nga policia shqiptare në vitin 1999 si anëtar i një bande kriminale për kryerjen e disa veprave penale, ndërsa në vitin 2008 është arrestuar në P. nga policia italiane.

1.6 Në lidhje me këto rrethana, në pyetësorët nr. 2 dhe nr. 3, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se nuk ka asnjë lidhje miqësore me këta shtetas, të cilët i ka njohur nëpërmjet shitëses së marketit të lagjes ndërsa po interesoheshin për blerjen e një banese që i përshtatej buxhetit të familjes së subjektit. Çifti B. kishte vendosur një çmim okazion për këtë apartament, për arsye emigrimi dhe pasi subjekti e pa apartamentin ishte dakord për ta blerë brenda një jave, siç kërkuan shitësit.

1.7 Në lidhje me adresën e banimit në Durrës, Lagjja nr. ***, rruga “****”, p. ***, k. ***, ku subjekti i rivlerësimit ka deklaruar disa apartamente: apartament nr. *** në DIPP-në e viteve 2007 – 2009 dhe në procesverbalin e ILDKPKI-së datë 8.7.2016; apartament nr. *** në DIPP-në e viteve 2010 - 2016; apartament nr. *** në DIPP-në e vitit 2017 dhe në pyetësorin nr. 1; apartament nr. *** në deklaratën *Vetting* – duke iu referuar dokumentacionit të depozituar në pyetësorin nr. 2 nga subjekti i rivlerësimit¹⁰, si dhe atij që Komisioni ka administruar nga ASHK Drejtoria

⁶ Kontratë shitjeje e pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.9.2007, noter M. Rr., depozituar nga subjekti i rivlerësimit edhe në ILDKPKI, sipas procesverbalit datë 22.7.2016.

⁷ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.7.2016, noter Z. Ç.

⁸ Sipas udhëzimit nr. 2, datë 4.4.2007, të EKB-së.

⁹ Sipas shkresës nr. *** prot., datë 29.6.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, subjekti nuk ka hetuar çështje në ngarkim të këtyre shtetasve. Ndërsa sipas sistemit TIMS rezulton se bashkëshortët A. e P. B. nuk kanë bërë udhëtime në të njëjtën datë/destinacion dhe në të njëjtin mjet udhëtues me subjektin e rivlerësimit apo bashkëshortin e saj.

¹⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 15.6.2023, e ASHK-së Durrës, drejtuar subjektit të rivlerësimit.

Durrës¹¹, është provuar se pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, me sip. 108.8 m², shkalla ***, kati ***, apartamenti nr. ***, ka qenë në pronësi të shtetasit A. B. dhe është në pronësi të shtetasve Anila e E. Bebeçi, ndërsa apartamentet nr. *** dhe nr. *** nuk kanë qenë asnjëherë në pronësi të subjektit dhe bashkëshortit të saj¹².

Analiza e burimeve të krijimit të apartamentit me sipërfaqe 108.8 m², Durrës

1.8 Referuar deklaratës *Vetting* dhe DIPP-së së vitit 2007 (korrigjuar në datën 23.7.2008¹³), subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burime të krijimit të kësaj pasurie: (i) të ardhurat nga shitja e apartamentit me sip. 59.38 m², në Lagjen nr. ***, Durrës; (ii) huat që në muajin gusht 2007 i ka marrë motrës M. L. në shumën 10,000 euro dhe kumatit M. Rr. në shumën 500,000 lekë; (iii) 800,000 lekë kursime *cash*, krijuar në vitet 2003 – 2006.

1.9 Në lidhje me burimin e parë “Të ardhurat nga shitja e apartamentit me sip. 59.38 m², në Lagjen nr. ***, Durrës”, Komisioni vëren se subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* blerjen e këtij apartamenti me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.9.1999, të zyrës së noterisë Durrës, në vlerën 1,000,000 lekë, me burim të ardhurat nga puna e saj si prokurore dhe e bashkëshortit, të ardhurat nga shitja e apartamentit në L., si edhe shitjen e tij me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.8.2007, të noterisë Durrës, me vlerë 1,900,000 lekë.

1.10 ASHK Drejtoria Durrës konfirmon¹⁴ se apartamenti nr. ***, me sip. 59.38 m², shk. ***, k. ***, p. ***, me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, i ndodhur në Lagjen nr. ***, rruga “****”, Durrës, me kontratë shitjeje¹⁵ datë 8.9.1999, ka kaluar nga pronësia e shtetas H. K. në pronësi të shtetasit E. B., kundrejt shumës 1,000,000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale.

1.11 Megjithëse sipas çmimit referencë¹⁶ të EKB-së për vitin 1999 duket se ky apartament është blerë 631,762 lekë më pak se çmimi referencë, nga hetimi që kreu Komisioni nuk rezultoi ndonjë situatë konflikti interesi¹⁷. Nga ana e saj, subjekti i rivlerësimit shpjegoi në pyetësorët nr. 2 dhe nr. 3 se nuk ka asnjë njohje personale me shtetasen H. K., por apartamenti ka qenë parafabrikat, i parregulluar në pjesën e brendshme dhe me pajisje që nga koha e ndërtimit, prandaj kanë rënë dakord për atë çmim. Për të përmirësuar kushtet e apartamentit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në pyetësorin nr. 3 se ka përdorur disa mobilie ekzistuese¹⁸ dhe ka bërë mobilim të ri me vlerë 55,000 – 60,000 lekë¹⁹.

1.12 Duke marrë në konsideratë shpjegimet e subjektit të rivlerësimit për gjendjen e apartamentit dhe shpenzimet e kryera për mobilimin e tij, mungesën e konfliktit të interesit, si dhe çmimin e

¹¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 23.3.2021, të ASHK-së Durrës, drejtuar Komisionit.

¹² ASHK Drejtoria Durrës konfirmon se: (i) pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, sip. 81 m², shk. ***, k. ***, ap. ***, është në pronësi të shtetasit H. B. dhe asnjëherë nuk ka qenë në pronësi të subjektit dhe bashkëshortit të saj (bashkëlidhur vërtetimi hipotekor nr. ***, datë 23.4.2003, nga ZVRPP-ja Durrës, ku pasuria nr. ***, në z. k. ***, figuron i regjistruar në emër të shtetasit H. B.); (ii) pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, me sip. 58 m², shk. ***, ap. ***, është në pronësi të H. D. dhe asnjëherë nuk ka qenë në pronësi të subjektit dhe bashkëshortit të saj.

¹³ Korrigjuar sipas procesverbalit datë 23.7.2008 në ILDKPKI, për sqarimin dhe plotësimin e burimit të krijimit të shtëpisë së blerë në vitin 2007.

¹⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 22.6.2023, të ASHK Drejtoria Durrës, drejtuar Komisionit.

¹⁵ Kontratë shitjeje pasurie të paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.9.1999, noter M. N..

¹⁶ VKM nr. 214, datë 28.4.1999, Enti Kombëtar i Banesave.

¹⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 29.6.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

¹⁸ Divanë, kolltukë, tavolinë, karrige, dhomë gjumi (krevat, dollap, komodinë), elektroshtëpiake (frigorifer, lavatriçe, TV).

¹⁹ Lyerje banese në vitin 1999; krevat tek për vajzën; vendosja e dritareve duralumini në vitin 2001, me vlerë rreth 30,000 lekë; blerja e një kondicioneri në vitin 2003, me vlerë 25,000 lekë.

tregut për vitet '90, Komisioni vlerëson se çmimi i blerjes së apartamentit me sip. 59.38 m² nuk është preferencial. Gjithashtu, Komisioni i përfshiu shpenzimet e mobilimit në analizën financiare²⁰.

1.13 Në lidhje me analizën financiare të burimit të krijimit të apartamentit me sip. 59.38 m², rezulton se në deklaratën *Vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim: (i) të ardhurat nga puna e saj si prokurore dhe nga puna e bashkëshortit E. B.; (ii) të ardhurat nga shitja e apartamentit në L..

i) Në lidhje me të ardhurat nga puna e subjektit si prokurore dhe nga puna e bashkëshortit E. B., Komisioni ka administruar dokumentacionin e nevojshëm nga punëdhënësit e tyre dhe ISSH-ja²¹.

ii) Në lidhje me të ardhurat nga shitja e apartamentit në L., subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting*: “Në vitin 1991 nga Reparti Ushtarak *** i rrethit K., bashkëshortit E. B. i është dhënë nga Komisioni i Strehimit një banesë 1+1 e ndodhur në Lagjen nr. ***, L., pallati nr. ***. Në datën 23.8.1999 është shitur shtëpia, sipas kontratës së shitjes nr. *** rep., nr. *** kol. tek noteri K., në shumën 500,000 lekë”. (Bashkëlidhur kontratë shitjeje e apartamentit²² datë 23.8.1999, ku E. e Anila Bebeçi i shesin shtetasit A. M. apartamentin 1+1, me çmim 500,000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale).

1.14 Për apartamentin në L., nga hetimi u provua se subjekti i rivlerësimit e ka përfituar me privatizim nga Ndërmarrja Komunale Banesa, në datën 11.8.1993, kundrejt çmimit 8,157 lekë²³. Gjithashtu, ASHK Zyra Vendore K., duke bashkëlidhur dokumentacionin përkatës, konfirmon²⁴ pronësinë fillestare të apartamentit në emër të Anila dhe E. Bebeçi, si dhe tjetërsimin me kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.8.1999, në emër të blerësit A. M.

1.15 Për sa më lart, Komisioni konstatoi se përputhet deklarimi i subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e administruar dhe nuk rezultuan problematika në lidhje me apartamentin me sip. 57 m², i ndodhur në L. dhe transaksionet e kryera me të.

1.16 Në lidhje me mundësitë financiare të subjektit të rivlerësimit për të blerë apartamentin me sip. 59.38 m² në Durrës, në shumën 1,000,000 lekë, bazuar në burimet e analizuara më lart, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e saj, për shkak të një balance pozitive në shumën 465,047 lekë.

1.17 Kjo analizë është kryer duke përdorur metodologjinë kumulative, sepse pasuria është blerë para deklarimit të parë, në vitin 2003. Ajo fillon nga viti 1993, kur subjekti i rivlerësimit ka krijuar të ardhura nga puna e saj në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor K. dhe vazhdon deri në datën e blerjes së këtij apartamenti. Në analizë janë përfshirë të ardhurat e subjektit të rivlerësimit, pensioni suplementar si ish-oficer i dalë në lirim i bashkëshortit, si dhe të ardhurat nga shitja e apartamentit

²⁰ Shpenzimet e mobilimit të këtij apartamenti janë përfshirë në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit, sikurse është deklaruar prej saj gjatë hetimit administrativ. Në rastet kur subjekti ka cilësuar llojin e shpenzimit, por jo vlerën, atëherë në analizë janë vendosur çmimet e tregut për mallra të caktuara (lyerja e banesës në vitin 1999 në vlerën 10,000 lekë; krevat për vajzën dhe krevat portativ për djalin në vitin 2000, në vlerën 8,000 lekë).

²¹ Shkresë nr. *** prot., datë 22.6.2023, nga ISSH-ja; shkresë nr. *** prot., datë 4.7.2023, nga ISSH Drejtoria Rajonale Durrës.

²² Kontratë shitjeje e pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.8.1999.

²³ Në pyetësoin nr. 2, subjekti depozitoi: (i) kontratë privatizimi banese datë 10.8.1993, e lidhur midis Ndërmarrje Komunale Banesa L. dhe qiramarrësit E. B.; (ii) kontratë shitjeje apartamenti datë 11.8.1993, midis Ndërmarrje Komunale Banesa L. dhe blerësit E. B., kundrejt çmimit 8,157 lekë etj.

²⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 19.7.2023, të ASHK Zyra Vendore Kurbin.

në L. në gusht të vitit 1999. Shpenzimet e jetesës për periudhën 1993 – fundvit 1999, kur nuk ka të dhëna nga INSTAT-i, janë përlogaritur si 30% e të ardhurave të subjektivit²⁵ dhe janë barazuar me pensionin e bashkëshortit, referuar qëndrimin të mbajtur nga Kolegji dhe praktikës së Komisionit.

1.18 Në lidhje me shitjen e apartamentit me sipërfaqe 59.38, të ndodhur në Durrës, rezultoi se:

1.18.1 Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj ia kanë shitur këtë apartament blerësit A. I. sipas kontratës²⁶ datë 22.8.2007, me çmimin 1,900,000 lekë, të paguar *cash* jashtë zyrës noteriale. Ky transaksion dhe pagimi i tatimit mbi të ardhurat nga shitja në datën 22.8.2007 konfirmohet edhe nga ASHK Drejtoria Durrës²⁷.

1.18.2 Për sa më lart, Komisioni konstatoi se përputhet deklarimi i subjektivit të rivlerësimit me dokumentacionin e administruar dhe nuk konstatohen problematika në lidhje me apartamentin me sip. 59 m², të ndodhur në Durrës.

1.19 Në lidhje me burimin e dytë të krijimit të apartamentit me sip. 108.8 m² “Huat që subjekti i rivlerësimit i ka marrë në muajin gusht 2007 motrës M. L. në shumën 10,000 euro dhe kunatit M. Rr. në shumën 500,000 lekë”, në pyetësonin nr. 2, Komisioni i ka kërkuar subjektivin të depozitonte dokumentacionin ligjor që provon burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësve M. L. për vlerën 10,000 euro dhe A. e M. Rr. për vlerën 500,00 lekë. Në përgjigje, subjekti i rivlerësimit ka depozituar ekstraktet historike nga QKB-ja: të personit fizik “M. L.”, me objekt aktiviteti “Stomatologji”; të personit fizik “M. Rr.”, me objekt aktiviteti “Noter”, i regjistruar në datën 4.4.2003; të shoqërisë “****” sh.p.k., me objekt aktiviteti “Arsim privat ***”, ku figuron si aksionere motra e subjektivit, znj. A. Rr..

1.20 Nga hetimi i Komisionit për aktivitetet tregtare të huadhënësve M. L., M. e A. Rr., si dhe të ardhurat e krijuara prej tyre, rezultoi se:

i) Sipas informacionit nga QKB-ja:

- M. L. figuron e regjistruar në datën 1.1.2003 si person fizik, me NIPT ***;
- M. Rr. figuron i regjistruar në datën 4.4.2003 si person fizik, me NIPT *** dhe në datën 14.1.2014 si person fizik me NIPT ***.

ii) Në ekstraktin historik²⁸ të shoqërisë “****” sh.p.k., e regjistruar në datën 26.5.2004, me NIPT, rezulton ***se A. Rr. është ortak me 16.67% të kuotave të shoqërisë.

iii) Sipas informacionit nga DRT-ja Durrës²⁹, administruar nga ILDKPKI-ja, ka rezultuar se:

- Subjekti “M. L.”, i regjistruar pranë DRT-së Durrës me NIPT ***, për periudhën 2003 – 2007 ka realizuar fitim në shumën 4,164,270 lekë.
- Subjekti “M. Rr.”, i regjistruar pranë DRT-së Durrës me NIPT ***, për periudhën 2003 – 2007 ka realizuar fitim në shumën 4,055,000 lekë.

²⁵ Referuar vendimit nr. 15/2021 (JR), datë 18.6.2021, pg. 21.41, i Kolegjit.

²⁶ Kontratë shitblerjeje e pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.8.2007, noter M. Rr..

²⁷ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 15.6.2023, të ASHK Drejtoria Durrës, paraqitur nga subjekti me përgjigjet e pyetësonit nr. 2, prova ***; faqe ***.

²⁸ Ekstrakt historik i printuar *online* nga faqja e QKB-së.

²⁹ Me shkresën nr. *** prot., datë 25.8.2017, të DRT-së Durrës.

iv) Sipas informacionit nga DRT Durrës, administruar nga Komisioni³⁰:

- Subjekti “M. Rr.”, regjistruar pranë DRT-së Durrës me NIPT ***, për periudhën 2003 – gusht 2008 ka realizuar fitim në shumën 5,254,300 lekë dhe është me përgjegjësi tatimore biznes i vogël me tatim të thjeshtuar mbi fitimin, prandaj nuk rezulton të ketë dividend.
- Subjekti “M. L.”, regjistruar pranë DRT-së Durrës me NIPT ***, nuk është regjistruar për përgjegjësinë tatimore në burim. Për periudhën mars 2005 – dhjetor 2008 ka paguar kontributet shoqërore dhe për periudhën mars 2005 – mars 2006 ka paguar sigurimet shëndetësore. Për periudhën qershor 2007 – dhjetor 2008 ka paguar tatimin mbi të ardhurat nga punësimi. Kjo shkresë informon mbi xhiron e personit fizik “Stomatologji M. L.”, për periudhën 1997 – 2008.
- Shoqëria “****” sh.p.k., e regjistruar me NIPT ***, për periudhën 2005 – 2008 ka realizuar fitim në shumën 9,737,127 lekë; ka paguar tatim mbi të ardhurat nga punësimi për periudhën mars 2005 – gusht 2008; ka paguar kontributet shoqërore për periudhën mars 2005 – gusht 2008; për periudhën 2004 – gusht 2008 nuk ka shpërndarë dividend.

v) Sipas shkresës nr. *** prot., datë 4.7.2023, ISSH-ja (Drejtoria e Arkivit të DRT-së Durrës) informon mbi pagën bruto dhe neto të huadhënësve M. L. (periudha janar 1999 – 2023), A. Rr. (periudha 2004 – 2023), M. Rr. (periudha shtator 1997 – 2021).

vi) Sipas shkresës nr. *** prot., datë 22.6.2023, ISSH-ja informon mbi pagën bruto dhe neto të huadhënësve M. L., M. Rr. e A. Rr., që nga muaji janar i vitit 2012, periudhë kjo pas datës kur subjekti i rivlerësimit ka marrë huat prej tyre.

Analiza financiare e burimit të krijimit të huas 10,000 euro, dhënë nga shtetasja M. L.

1.21 Kjo analizë është kryer duke u bazuar në të ardhurat dhe shpenzimet familjare të jetesës së huadhënësës, për shkak se: (i) shumën e dhënë hua është proporcionale në lidhje me shumën totale të investimit³¹ nga ana e subjektit; (ii) në vlerë absolute shumën 10,000 euro duket të jetë një vlerë e mundur për profesionin e dentistit, sikurse provohet edhe nga të dhënat tatimore.

1.22 Kjo analizë është kryer duke përdorur metodologjikë kumulative, pasi motra e subjektit të rivlerësimit nuk është subjekt deklarues. Në analizë janë përfshirë të ardhurat neto të klinikës dentare për vitet 2005 dhe 2006³². Shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur sipas standardit të ILDKPKI-së dhe përbërjes familjare të shtetasës M. L..

1.23 Nga analiza financiare ka rezultuar se për periudhën 2005 – gusht 2007, shtetasja M. L., motra e subjektit të rivlerësimit, ka pasur të ardhura të mjaftueshme për t’i dhënë subjektit të rivlerësimit huan 10,000 euro në gusht të vitit 2007³³ dhe, për këtë arsye, kjo hua është përfshirë si burim i ligjshëm në analizën financiare për blerjen e apartamentit me sip. 108.8 m² në Durrës.

³⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 22.6.2023, nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës.

³¹ Huaja 10,000 euro përbën 24% të vlerës së investimit.

³² Nga të dhënat nga DRT Durrës, nuk rezulton xhiro ose fitim për vitin 2007, pasi në këtë vit personat fizikë deklarorin në organet vendore/Bashki.

³³ *Mundësia për kursim e shtetasës M. L. në periudhën 2005 – gusht 2007 ka qenë 1,714,394 lekë: të ardhurat e shtetasës M. L. nga klinika dentare 4,164,270 lekë; shpenzime 2,449,876 lekë (shpenzimet e jetesës për 4 persona 1,240,776 lekë plus huaja që i ka dhënë subjektit 10,000 euro ose 1,209,100 lekë).*

Analiza financiare e burimit të huas 500,000 lekë, dhënë nga shtetasi M. Rr.

1.24 Kjo analizë është kryer duke përdorur metodologjikë kumulative, duke u bazuar në të ardhurat dhe shpenzimet familjare të jetesës së huadhënësit, për shkak se: (i) shuma e dhënë hua është proporcionale në lidhje me shumën totale të investimit³⁴ nga ana e subjektit; (ii) në vlerë absolute shuma 500,000 lekë duket të jetë një vlerë e mundur për t'u krijuar për profesionin e noterit, sikurse provohet edhe nga të dhënat tatimore.

1.25 Në analizë janë përfshirë: të ardhurat nga aktiviteti i noterit M. Rr. për vitet 2005 e 2006³⁵; të ardhurat nga paga e motrës së subjektit, znj. A. Rr. dhe njëherësh bashkëshorte e huadhënësit M. Rr.. Për periudhën e analizuar nuk janë përfshirë të ardhura nga ndonjë shpërndarje e mundshme dividendi në shoqërinë “****” sh.p.k., ku shtetasja A. Rr. që nga tetori i vitit 2004³⁶ është aksionere, pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me dokumentacion të ardhura të tilla. Shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur sipas standardit të ILDKPKI-së dhe sipas përbërjes familjare të huadhënësit.

1.26 Nga analiza financiare ka rezultuar se për periudhën 2005 – gusht 2007 shtetasi M. Rr. ka pasur të ardhura të mjaftueshme për t'i dhënë subjektit të rivlerësimit huan 500,000 lekë³⁷ e, për këtë arsye, kjo hua është përfshirë si burim i ligjshëm në analizën financiare për blerjen e apartamentit me sip. 108.8 m², në Durrës.

1.27 Në lidhje me burimin e tretë të krijimit të apartamentit me sip. 108.8 m² “800,000 lekë kursime *cash* krijuar në vitet 2003 – 2006”, në pyetësin nr. 3, Komisioni ka pyetur subjektin e rivlerësimit se gjatë cilës periudhë është krijuar kjo gjendje *cash* prej 800,000 lekësh dhe sa ka qenë shuma *cash* e kursyer çdo vit³⁸. Subjekti sqaroi se kursimet *cash* prej 800,000 lekësh, të deklaruara në datën 31.12.2006, janë kursyer që nga viti 2004, konkretisht: në vitin 2004 nga të ardhurat e saj dhe të bashkëshortit në datën 31.12.2004 ka pasur 200,000 lekë *cash*; në datën 31.12.2005 të ardhurat *cash* janë shtuar me 100,000 lekë, duke e çuar vlerën në 300,000 lekë *cash* kursime; në vitin 2006 ka kursyer edhe 500,000 lekë të tjera, prandaj në fund të vitit 2006 vlera e kursyer *cash* është 800,000 lekë.

1.28 Në lidhje me këtë burim, deri në fazën e dërgimit të rezultateve për subjektin e rivlerësimit, Komisioni vlerësoi të mos i marrë në konsideratë deklaratimet e saj në procesverbalin korrigjues të DIPP-së së vitit 2007 (bërë nga subjekti pranë ILDKPKI-së në korrik të vitit 2008) dhe sqarimet e saj në pyetësin nr. 3, sepse: (i) shumat *cash* nuk janë deklaruar në DIPP-të përkatëse të viteve 2004, 2005 dhe 2006; (ii) shuma 800,000 lekë është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit vetëm atëherë kur ajo ka deklaruar për herë të parë burimet që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit në shtator të vitit 2007. Pra, duket se subjekti i rivlerësimit i ka deklaruar kursimet *cash* në shumën 800,000 lekë në fund të vitit 2006, për të justifikuar plotësimin e çmimit për blerjen e apartamentit.

³⁴ Huaja prej 500,000 lekësh përbën 10% të vlerës së investimit.

³⁵ Nga të dhënat nga DRT-ja Durrës nuk rezulton xhiro ose fitim për vitin 2007, pasi në këtë vit personat fizikë deklarorin në organet vendore/bashki.

³⁶ Shihni ekstraktin historik të shoqërisë “****” sh.p.k. në faqen zyrtare të QKB-së.

³⁷ Mundësia për kursim e shtetasit M. Rr. në periudhën 2005 – gusht 2007 ka qenë 3,325,845 lekë: të ardhurat 4,756,427 lekë (nga M. Rr. si noter 4,054,300 lekë plus nga A. Rr., bashkëshortja 702,127 lekë); shpenzime 1,430,582 lekë (shpenzimet e jetesës për 3 persona 930,582 lekë plus huaja që i ka dhënë subjektit 500,000 lekë).

³⁸ Trajtuar hollësisht në rubrikën “Konstatime të tjera”.

1.29 Nga ana tjetër, në analizën financiare për blerjen e apartamentit me sip. 108.8 m² janë përfshirë kursimet nga të ardhurat familjare të krijuara gjatë vitit 2007, deri në datën e blerjes së apartamentit.

Analiza financiare për blerjen e apartamentit me sip. 108.8 m², në Durrës

1.30 Nisur nga dokumentet e administruara deri tani, si dhe nga sqarimet e subjektit të rivlerësimit, Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 1.1.2007 – 11.9.2007, kur subjekti bleu apartamentin me sip. 108.8 m² në Durrës, me vlerë 5,000,000 lekë.

1.31 Sipas kësaj analize në tabelën më poshtë, duket se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të investuar shumën 5,000,000 lekë për blerjen e apartamentit, për shkak të një balance negative në shumën -1,065,017 lekë.

Tabela nr. 1

Përshkrimi	1.1.2007 – 11.9.2007
Pasuri	4,996,509
Blerë apartamenti me sip. 108.8 m ² , Lagjja nr. ***, Durrës	5,000,000
<i>Shtesa/pakësime likuiditeteve</i>	<i>-3,491</i>
Gjendja e likuiditeteve	2,395
Të ardhura të dokumentuara	4,319,785
Të ardhura nga paga e subjektit	641,925
Të ardhura nga pensioni i bashkëshortit	68,760
Marrë hua nga motra e subjektit 10,000 euro, gusht 2007	1,209,100
Marrë hua nga kunati i subjektit 500,000 lekë, gusht 2007	500,000
Përfitur nga shitja e apartamentit në Durrës	1,900,000
Shpenzime	388,293
Shpenzime jetese	378,793
Shpenzime udhëtimi TIMS	-
Paguar në Hipotekë	9,500
Mundësia për kursime	-1,065,017

1.32 Për sa më lart deri në këtë fazë të hetimit, duket se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj:

- nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të investuar shumën 5,000,000 lekë në blerjen e apartamentit me sip. 108.8 m², në Durrës, për shkak të balancës negative në shumën -1,065,017 lekë;
- e kanë blerë këtë apartament 3,821,504 lekë (ose 43%) më lirë se çmimi referencë i EKB-së për vitin përkatës, në rrethana jo të qarta nga një person me precedent penal, pavarësisht se nuk rezultoi të ketë konflikt interesi.

1.33 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i ngarkoi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit në lidhje me mungesën e të ardhurave të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e apartamentit me sip. 108.8 m² në Durrës, si dhe të japë shpjegime bindëse në lidhje me rrethanat e blerjes së apartamentit me çmim 43% më lirë se çmimi referencë i EKB-së nga një person me precedent penal.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me barrën e provës

1.34 Në prapësime, në lidhje me rrethanat e blerjes së apartamentit me çmim 43% më lirë se çmimi referencë i EKB-së, subjekti i rivlerësimit i është përmbajtur shpjegimeve të dhëna në pyetësorë dhe ka shtuar argumentin se fqinjët e saj apartamentet e tyre në të njëjtin pallat i kanë blerë me çmim shumë më të lirë për metër katror sesa apartamenti i saj, vërtetuar kjo me kontratat e shitblerjes të depozituara në pyetësorë. Për çmimin referencë, subjekti pretendon se ajo dhe bashkëshorti i saj nuk kanë pasur asnjë dijenie se në atë periudhë ka pasur çmime referencë për shitblerjen e apartamenteve. Ky fakt nuk i është bërë i ditur as nga shitësi, as nga noteri e as nga ZVRPP-ja Durrës. Në kontratë palët kanë deklaruar çmimin real të blerjes së këtij apartamenti. Për këto arsye, subjekti beson se nuk ka vend për dyshime për një çmim më të lartë apo preferencial të blerjes së apartamentit prej saj dhe bashkëshortit.

1.35 Në lidhje me konstatimin se ky apartament është blerë me çmim më të lirë se çmimi referencë i EKB-së pikërisht nga një person me precedent penal, subjekti ka shpjeguar në prapësime se ajo dhe bashkëshorti i saj nuk kanë asnjë lidhje miqësore me shtetasit A. e P. B. dhe marrëdhënia e vetme që ka pasur me këta shtetas është kontrata e shitblerjes së apartamentit e vitit 2007. Me faktin që shtetasi A. B. ka precedent penal, subjekti është vënë në dijeni kur është njohur me rezultatet e hetimit të dërguar nga Komisioni. Për këto arsye, subjekti pretendon se nuk ka konflikt interesi me këta shtetas. Të njëjtat shpjegime subjekti i ka dhënë edhe në seancën dëgjimore.

1.36 Në lidhje me konstatimin e Komisionit se subjekti dhe bashkëshorti nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të investuar shumën 5,000,000 lekë për blerjen e apartamentit me sip. 108.8 m² në Durrës, për shkak të balancës negative prej -1,065,017 lekësh, subjekti i është referuar edhe një herë shumës 800,000 lekë, gjendje *cash* e krijuar në vitet 2003 – 2006, si burimi i tretë i krijimit të apartamentit me sip. 108.8 m² dhe e ka shpjeguar atë duke u ndalur në tri momente:

1.36.1 *Së pari*, vitet 2004 – 2006 kanë qenë vitet e para të deklarimit të gjendjes *cash* dhe subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur as qartësinë dhe as trajnimin e duhur për deklarimin e saj në rubrikën e aseteve. Në mbështetje të këtij argumenti, subjekti vijon të shpjegojë që në DIPP-në e vitit 2007 ka deklaruar se deri në datën 31.12.2006 nga të ardhurat familjare ka kursyer gjendje *cash* 800,000 lekë. Mosdeklarimi i gjendjes *cash* në faqen e aseteve nuk është bërë prej saj, duke menduar se i ka deklaruar direkt në faqen e të ardhurave dhe se tepricat nga pagat janë të mjaftueshme për të kursyer gjendjen *cash* prej 800,000 lekësh.

1.36.2 *Së dyti*, subjekti i rivlerësimit nënvizon faktin se pasi është thirrur në ILDKPKI në korrik të vitit 2008 për të sqaruar burimet e të ardhurave që kishin shërbyer për blerjen e apartamentit, ajo ka deklaruar edhe shumën që realisht ka pasur *cash* në banesë dhe që ka përdorur për blerjen e apartamentit, si dhe ka plotësuar formularin datë 23.7.2008 pranë ILDKPKI-së, duke korrigjuar kështu mangësinë e deklarimit në vitet e kaluara për shkak të moskuptimit drejt të mënyrës së deklarimit. Subjekti i rivlerësimit thekson se nga ky moment në vitet në vijim e ka bërë këtë deklaram në mënyrë të saktë e të vazhdueshme.

1.36.3 *Së treti*, subjekti i rivlerësimit shpjegon se bazuar në analizën e Komisionit, ajo dhe bashkëshorti kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për të kursyer këtë shumë *cash* gjatë viteve 2004 – 2006, e cila më pas në vitin 2007 është përdorur për blerjen e apartamentit, fakt të cilin

e ka evidentuar edhe ILDKPKI-ja, duke mos konstatuar asnjë problematikë në lidhje me këtë gjendje *cash*.

1.37 Për sa më sipër, subjekti i rivlerësimit kërkon nga Komisioni të njihet shuma *cash* prej 800,000 lekësh, e deklaruar nga të ardhura të ligjshme, dhe të bëhet pjesë e raportit të analizës financiare.

Vlerësimi i Komisionit

1.38 Në lidhje me blerjen e apartamentit me çmim më të lirë se çmimi referencë i EKB-së dhe nga një person me precedent penal, referuar: shpjegimeve të subjektit; hetimit që bëri Komisioni për ndonjë situatë konflikti interesi midis subjektit dhe shitësve të apartamentit dhe nuk rezultoi asnjë e tillë; sistemit TIMS, nga ku rezultoi që subjekti apo personat e lidhur me të nuk kanë kryer udhëtime me shitësit e apartamentit; deklarimit konstant të subjektit të rivlerësimit se nuk e njihje shtetasin A. B. dhe as bashkëshorten e tij, por i ka takuar vetëm kur ka lidhur kontratën e shitjes së apartamentit me ta – atëherë Komisioni nuk gjen elemente për të ngritur dyshime për favorizim të subjektit nga personat që i kanë shitur apartamentin me sip. 108.8 m² dhe vlerëson se çmimi i blerjes së këtij apartamenti është një okazion real që i është ofruar subjektit të rivlerësimit.

1.39 Në lidhje me përfshirjen e shumës *cash* 800,000 në analizën financiare si burim i ligjshëm i krijimit të apartamentit me sip. 108.8 m², Komisioni vlerëson se subjekti ka dhënë shpjegime të mjaftueshme dhe bindëse lidhur me pasaktësitë në deklarimin e gjendjeve të kursimeve *cash* në deklaratat periodike të viteve 2004 – 2006, për shkak të mosdeklarimit të gjendjes *cash* në këto vite. Mundësia për krijimin e gjendjes *cash* në këto vite mbështetet edhe nga analiza e Komisionit, analizë e cila rezulton me balancë pozitive në këto vite. Në këtë vështrim, Komisioni mban në konsideratë edhe praktikën e Kolegjit³⁹ se pasaktësitë në deklarimet periodike, të pashoqëruara me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive, nuk mund të konsiderohen si shkaqe që mund të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në kuadër të këtij procesi.

1.40 Veç sa më sipër, duke vlerësuar disa fakte e rrethana, konkretisht:

- i) deklarimet e subjektit në ILDKPKI në korrik të vitit 2008 (brenda 10 muajve nga data e blerjes së apartamentit) janë deklarime të kohës dhe që kanë korrigjuar deklarimet për vitet 2004 – 2006 në lidhje me gjendjen *cash*, si dhe për sa kohë që deklarimet periodike të interesave të deklaruara më parë në ILDKPKI janë objekt verifikimi dhe në bazë të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 mund të shërbejnë si provë në këtë proces (referuar praktikës së Kolegjit⁴⁰);
- ii) mundësinë financiare të saj për të krijuar kursimet deri në fund të vitit 2006 për shkak të balancës pozitive në këtë periudhë, e cila është e konsiderueshme dhe nuk rezulton të jetë

³⁹ Vendimi nr. 37, datë 24.11.2021, i Kolegjit: “Pavarësisht deklarimeve jo të plota të subjektit në vitet 2003 – 20 = 04 për pasurinë likuiditet, nga leximi dhe analiza logjike e deklarimeve të bëra prej tij qoftë në DPV-në e vitit 2004, qoftë në shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ, në çdo rast, subjekti justifikon me burime të ligjshme pasurinë e deklaruar prej tij edhe në version e pranuar prej Komisionerit Publik se ai zotëron me bashkëshorten të gjithë shumën. Në lidhje me këtë çështje, Kolegji nënvizon qëndrimin e tij të konsoliduar tashmë se pasaktësitë në deklarime periodike të pashoqëruara me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive, nuk mund të konsiderohen si shkaqe që mund të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në kuadër të këtij procesi”.

⁴⁰ Vendimi nr. 33/2021, i Kolegjit, subjekti i rivlerësimit N. T. (pika 43): “...trupit gjykues vlerëson se deklarimi i subjektit në vitin 2009 duhet lexuar e kuptuar si korrigjim i atij të vitit 2008, për sa kohë objekt i verifikimit janë deklarimet periodike të interesave të deklaruara më parë në ILDKPKI, të cilat në bazë të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 mund të shërbejnë si provë në këtë proces, e për sa kohë që pavarësisht pasaktësisë në deklarimin e vitit 2008, nga analiza financiare e kryer në Kolegj për vitin 2008, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur një tepricë pozitive në këtë vit”.

shpenzuar nga subjekti gjatë këtyre viteve duke blerë ndonjë pasuri të luajtshme apo të paluajtshme, apo ndonjë investim/shpenzim tjetër;

iii) faktin që subjekti i rivlerësimit ka vijuar të deklarojë saktë gjendjen e likuiditeteve në vitet në vazhdim – Komisioni arsyeton se kemi të bëjmë me një pasaktësi, e cila nuk shoqërohet me mungesë burimesh të ligjshme për krijimin e saj, si dhe është korrigjuar nga subjekti në kohë reale me deklaratimet e saj në ILDKPKI, duke e deklaruar shumën 800,000 si burim në krijimin e pasurisë apartament me sip. 108.8 m². Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë likuiditete dhe mjete financiare që justifikojnë kërkesat e nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

1.41 Për sa më lart, Komisioni krijon bindjen se pasaktësitë e krijuara për shkak të mosdeklarimit të gjendjes *cash* në vitet 2004 – 2006 nga subjektit i rivlerësimit mbeten shkaqe të veçuara, të cilat nuk mund të përbëjnë shkak të mjaftueshëm për aplikimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, prandaj vendosi të përfshijë në analizën financiare shumën 800,000 lekë, si burim për blerjen e apartamentit objekt shqyrtimi. Në këtë mënyrë, rezultati financiar për blerjen e apartamentit, që i takon periudhës 1 janar – 11 shtator 2007, ndryshon nga -1,065,017 lekë në -65,017 lekë, e cila konsiderohet nga Komisioni si një balancë financiare negative në vlerë të papërfillshme, që nuk mund të penalizojë subjektin e rivlerësimit me një vendimmarrje për shkarkim nga detyra në lidhje me kriterin e pasurisë. Ky qëndrim i Komisionit mbështet edhe në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit⁴¹.

2. Llogari bankare në Raiffeisen Bank në emër të djalit të subjektit E. B., duke futur edhe kursimet e familjes, hapur në datën 20.1.2012. Llogari në shumën 399,375 lekë.

2.1 Kjo pasuri është deklaruar njësoj në deklaratën *Vetting* edhe nga bashkëshorti dhe nga djali i subjektit të rivlerësimit.

2.2 Referuar dokumentacionit bashkëlidhur deklaratës *Vetting*⁴² dhe atij nga Raiffeisen Bank⁴³, nga lëvizjet e kësaj llogarie rrjedhëse në emër të shtetasit E. B. evidentohet se ajo është çelur në janar të vitit 2012 dhe ka shërbyer si llogari mbajtëse edhe për depozitën e trajtuar në pikën 3 më poshtë. Gjithashtu, rezulton se shuma 399,225 lekë është krijuar nga dy depozitime, konkretisht: (i) shuma 300,000 në datën 8.10.2015; (ii) shuma 100,000 lekë në datën 23.5.2016.

Analiza financiare e burimit të krijimit të kësaj llogarie

2.3 Nga analiza financiare që kreu Komisioni mbi mundësinë e krijimit të këtyre depozitimeve në datat e kryerjes së tyre nga djali i subjektit me burim *kursimet familjare*, ka rezultuar se subjekti dhe familja e saj kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar këto kursime/depozita⁴⁴.

⁴¹ Vendimet e Kolegjit: nr. 9/2020 (JR); nr. 16/2022 (JR); nr. 37/2021 (JR); nr. 20/2022 (JR); nr. 33/2021 (JR); nr. 1/2022 (JR); nr. 27/2022.

⁴² Nxjerrjen e llogarisë në emër të shtetasit E. B. pranë Raiffeisen Bank, për periudhën 20.1.2012 – 31.12.2016, ku gjendja e llogarisë në datën 31.12.2016 është 399,375 lekë.

⁴³ Raiffeisen Bank, me *email*-in datë 6.12.2018, ka bashkëlidhur tabelën përmbledhëse të llogarive në emër të shtetasit E. B., ku konfirmohet shuma 399,225 lekë në datën 27.1.2017.

⁴⁴ *Mundësia për kursime 330,176 lekë, në datën 8.10.2015* (të ardhura totale të dokumentuara 1,780,280 lekë minus pasuri 669,984 lekë minus shpenzime 780,120 lekë); *Mundësia për kursime 537,368 lekë, në datën 23.5.2016* (të ardhura totale të dokumentuara 879,664 lekë minus pasuri -89,215 lekë minus shpenzime 431,511 lekë).

2.4 Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se përputhet deklarimi i subjektit të rivlerësimit me të dhënat bankare dhe për këtë pasuri nuk konstatohen mangësi.

3. Depozitë në shumën 2,804,546 lekë, gjendje në datën 20.1.2017

Burimi i krijimit: të ardhura nga puna si stomatolog dhe kursimet nga pagat e prindërve të tij Anila Bebeçi dhe E. B..

3.1 Kjo pasuri është deklaruar njësoj në deklaratën *Vetting* edhe nga bashkëshorti i subjektit.

3.2 Raiffeisen Bank⁴⁵ ka konfirmuar depozitën në shumën 2,804,546 lekë, datë 27.1.2017.

3.3 Nga lëvizja e llogarisë së kësaj depozite evidentohet se në këtë llogari janë kryer derdhje në mënyrë periodike në shumat dhe në datat e treguara në tabelën më poshtë. Këto vlera monetare, menjëherë pas derdhjes në llogari, janë investuar në depozitë me afat.

Tabela nr. 2

Nr.	Data e depozitimit	Shuma në lekë
1	20.1.2012	100,000
2	20.4.2012	100,000
3	22.1.2013	100,000
4	24.4.2013	250,000
5	26.7.2013	250,000
6	28.10.2013	400,000
7	4.8.2014	800,000
8	5.11.2014	400,000
9	7.5.2015	400,000
	Total	2,800,000

3.4 Në pyetësin nr. 2, subjekti ka dhënë shpjegime mbi burimin e ligjshëm të shumave që ka depozituar ndër vite në llogarinë bankare të djalit E. B., e cila shërben edhe për mbajtjen e depozitës me afat objekt shqyrtimi, që nga momenti i çeljes së llogarisë së djalit. Sipas këtyre shpjegimeve, në datën 20.1.2012, subjekti ka hapur llogari në emër të djalit të saj në Raiffeisen Bank, ku ka depozituar 100,000 lekë dhe në fund të vitit 2012 balanca është 200,000 lekë. Burimi i ligjshëm i parave të depozituara në këtë llogari që nga momenti i hapjes deri në vitin 2017 janë nga paga e saj, bashkëshortit dhe djalit, si dhe interesi i përfituar nga banka dhe, konkretisht, në lidhje me pagat si burim:

- Për vitin 2012, kursimet nga pagat janë 700,000 lekë. Kursimet vjetore janë ruajtur në gjendje *cash* nga pagat dhe janë depozituar në këtë llogari në emër të djalit të subjektit. Në fund të vitit 2012, balanca është 203,945 lekë (500,000 lekë *cash* kursime).
- Për vitin 2013, balanca në këtë llogari është 1,214,513 lekë. Kursimet *cash* 500,000 lekë të vitit 2012 janë përdorur për blerjen e automjetit në vitin 2013.
- Për vitin 2014, kursimet nga pagat janë 1,200,000 lekë dhe janë depozituar në llogarinë e djalit të subjektit, ku në fundvit balanca është 2,418,297 lekë.

⁴⁵ Sipas *email*-it datë 6.12.2018 dhe tabelës përmbledhëse të llogarive në emër të shtetasit E. B. bashkëlidhur, të dërguara nga Raiffeisen Bank me shkresën nr. *** prot., datë 12.7.2017, pranë ILDKPKI-së.

- Për vitin 2015, kursimet nga pagat janë 900,000 lekë dhe 200,000 lekë *cash* e mbetur gjendje. Llogaria e djalit të subjektit në fundvit është 3,104,395 lekë.
- Për vitin 2016, balanca e llogarisë është 2,804,546 lekë.
- Për vitin 2017, të ardhurat vjetore në total janë në vlerën 2,232,471 lekë. Llogaria e djalit të subjektit në fillim të vitit 2017 ka qenë me gjendje 2,804,546 lekë dhe në fundvit ka qenë 702,353 lekë.

3.5 Në lidhje me *interesin e përfituar nga banka*, si burim i krijimit të parave që janë depozituara në llogarinë e djalit të subjektit, është evidentuar se shumata e depozituara periodikisht në bankë janë investuar dhe riinvestuar në depozita me afat, duke gjeneruar kështu interesa bankarë, të cilat janë rikapitalizuar me principalin e depozitës, duke rritur kështu vlerën e depozitës përfundimtare.

Analiza financiare e burimit të krijimit të kësaj depozite

3.6 Për të verifikuar mundësinë financiare të shtetasit E. B. dhe prindërve të tij, për krijimin e depozitës në fjalë, në shumën 2,800,000 lekë, Komisioni ka kryer analizën financiare për vitet kur janë depozituar vlerat monetare, sikurse është treguar në tabelën përfundimtare të rezultateve të hetimit, për vitet përkatëse (shihni tabelën në pikën 13 të vendimit). Sipas kësaj analize, subjekti i rivlerësimit dhe familja e saj kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të kryer depozitimet gjatë viteve 2012, 2013, 2014 dhe 2015.

3.7 Komisioni vlerësoi të pranojë saktësimin e subjektit të rivlerësimit në pyetësonin nr. 3, se likuiditeti i deklaruar në DIPP-në e vitit 20014, si kursime nga pagat në vlerën 1,200,000 lekë, është derdhur në llogarinë e djalit E. B. në Raiffeisen Bank, duke mbajtur parasysh faktin që subjekti i rivlerësimit nuk mund të ketë kursyer njëkohësisht 1,200,000 lekë *cash* dhe 1,200,000 lekë për t'u derdhur në llogari bankare⁴⁶.

4. Depozitë bankare në Bankën Kombëtare Tregtare në emër të bashkëshortit të subjektit E. B., krijuar më 1.8.2011. Vlera: 2,000,000 lekë.

4.1 Kjo pasuri është deklaruar në deklaratën *Vetting* edhe nga bashkëshorti i subjektit, duke deklaruar edhe burimet e krijimit të saj, që janë: *“Dhuratë nga babai im A. B., të shumës 1,000,000 lekë dhe kursimet nga pagat e bashkëshortes dhe të pagës sime si instruktor në autoshkollë”*. Ndërsa, subjekti ka deklaruar: *“Të ardhura në shumën 1,000,000 lekë, si dhuratë nga vjehri im A. B. bashkëshortit tim E. B., të përfituara nga shitja e pronës në Gjirokastër. Nuk disponoj dokumentacion justifikues, pasi vjehri im ka ndërruar jetë në vitin 2014...”*.

4.2 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2011: *“(i) shuma 2,000,000 lekë në numrin e llogarisë *** në BKT Durrës, në emër të bashkëshortit tim E. B., derdhur në datën 29.8.2011, me një afat 1-vjeçar, me interes 6.2%; (ii) dhuratë bashkëshortit tim nga babai i tij A. B., në shumën 1,000,000 lekë, për shkak të shitjes së tokës në Gjirokastër”*.

4.3 Subjekti i rivlerësimit, bashkëshorti dhe djali i saj, në DIPP-në e viteve 2012 dhe 2013 kanë deklaruar depozitë bankare në BKT, me afat 1-vjeçar. Vlera: 2,000,000 lekë. Interesi i përfituar:

⁴⁶ Për më shumë hollësi, referojuni rubrikës “Konstatime të tjera”.

111,092 lekë. Kjo depozitë bankare është deklaruar periodikisht në DIPP-të vjetore deri në vitin 2017, së bashku me interesat vjetorë për çdo vit.

4.4 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*: (i) përshkrim të llogarisë bankare nr. ***, në BKT-në Durrës, në emër të bashkëshortit E. B., ku përshkruhet se në datën 29.8.2011 bashkëshorti ka derdhur në depozitë shumën 2,000,000 lekë; (ii) dy kontrata depozite bankare të lidhura, përkatësisht në datat 18.9.2013 dhe 19.9.2016, midis shtetasit E. B. dhe BKT-së, për shumën 2,000,000 lekë, me afat 1-vjeçar dhe shuma interesi, përkatësisht 82,000 lekë dhe 15,987 lekë.

4.5 BKT-ja konfirmon⁴⁷ depozitë në emër të shtetasit E. B., me gjendje 2,000,004 lekë, në datën 27.1.2017.

4.6 Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave konfirmon⁴⁸: (i) në emër të shtetasit E. B., transaksione bankare me vlerë 2,000,000 lekë “Derdhje në depozitë në datën 29.8.2011 në llogarinë nr. ***”; (ii) transaksione në emër të shtetasit A. B., për shitje trualli në vlerën 27,072,000 lekë, kryer në datën 1.6.2011⁴⁹.

4.7 Komisioni ka administruar nga ILDKPKI-ja⁵⁰ kontratën datë 17.9.2012, për hapjen e depozitës bankare 1-vjeçare, që është rinovuar çdo vit sipas kontratave të datave 18.9.2014, 18.9.2015 dhe 20.9.2017 pranë BKT-së, për shumën 2,000,000 lekë.

4.8 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka depozituar shkresën nr. *** prot., datë 21.6.2023, të BKT-së, që konfirmon se shtetasi E. B. ka arkëtuar në datën 29.8.2011 shumën 2,000,000 lekë, të cilën e ka investuar në kontratë depozite me afat 1-vjeçar. Kjo depozitë është mbyllur në datën 17.9.2012, për të tërhequr interesin dhe është investuar sërish me afat 1-vjeçar. Kështu është vepruar periodikisht çdo vit. Bashkëlidhur kësaj shkrese është edhe një përshkrim i lëvizjeve të kësaj llogarie që nga data e hapjes deri në datën e shkresës.

4.9 Për sa më lart, duket se kontrata e depozitës është hapur në datën 29.8.2011, pas datës 1.6.2011, kur shtetasi A. B. ka shitur tokën në Gjirokastrë.

4.10 Në lidhje me burimin e krijimit “*Dhuratë e shumës 1,000,000 lekë nga babai A. B.*”, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar pranë ILDKPKI-së⁵¹ se vjehri i saj ka ndërruar jetë në vitin 2014⁵² dhe për shkak të marrëdhënieve me familjen e origjinës⁵³ nuk disponojnë dokumentacion dhe nuk kanë dijeni për shumën që vjehri ka përfituar nga shitja e tokës. Bashkëshorti i subjektit e ka marrë dorazi, pa dokumentacion, shumën dhuratë nga babai i tij.

4.11 Në lidhje me vlerën e të ardhurave që shtetasi A. B. ka përfituar nga ky transferim, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka dhënë të njëjtat shpjegime që ka dhënë para ILDKPKI-së dhe ka shtuar se pasuria e vjehrit të saj është shitur në datën 1.6.2011, në vlerën 27,072,000 lekë, por ajo dhe bashkëshorti nuk kanë qenë në dijeni të kësaj shitjeje deri në vitin

⁴⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 24.7.2017, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 10.5.2017, e DPPParave dhe përgjigjia e këtij institucioni nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 24.1.2022, të administruara përkatësisht në dosjen e ILDKPKI-së dhe Komisionit.

⁴⁹ Sipas kontratës së shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.6.2011.

⁵⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 11.3.2021, të ILDKPKI-së.

⁵¹ Referuar procesverbalit datë 8.7.2016, të ILDKPKI-së.

⁵² Në pyetësorin nr. 1, subjekti ka depozituar certifikatat e vdekjes datë 11.2.2021 të vjehrit dhe vjehrrës së saj, të cilët kanë ndërruar jetë përkatësisht në datën 11.3.2014 dhe në datën 7.5.2018.

⁵³ Referuar certifikatës së vdekjes datë 11.2.2021, që subjekti ka depozituar në pyetësorin standard, rezulton se edhe vjehra e saj ka ndërruar jetë në datën 7.5.2018.

2011, kur vjehri i dhuroi bashkëshortit shumën 1,000,000 lekë pas shitjes së pasurisë. Bashkë me shpjegimet, subjekti i rivlerësimit ka depozituar përgjigjen datë 20.6.2023, nga ASHK Drejtoria Durrës dhe dokumentacionin bashkëlidhur.

4.12 Nga ky dokumentacion rezultoi se sipas vërtetimit hipotekor datë 30.5.2011, në emër të shtetasit A. B., vjehri i subjektit, është regjistruar pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, e llojit truall me sip. 1465 m², ndodhur në lagjen “****”, Durrës. Këtë pasuri, shtetasi A. B. ia ka shitur shoqërisë “****” sh.p.k., sipas kontratës datë 1.6.2011, kundrejt vlerës 27,072,000 lekë, duke paguar edhe tatimin me vlerë 2,031,046 mbi të ardhurat nga shitja⁵⁴. Këtë truall, vjehri i subjektit e ka fituar sipas vendimit nr. ***, datë 2.9.1998, të KKKPronave Gjirokastër si trashëgimtar i babait të tij I. B., ish-pronar dhe sipas kontratës së pjesëtimit vullnetar nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.5.2000, e lidhur midis trashëgimtarëve të ish-pronarit I. B.. Sipas vërtetimit hipotekor datë 22.6.2011, trualli me sip. 1.465 m² është regjistruar në emër të shoqërisë “****” sh.p.k.

4.13 Referuar edhe dokumentacionit që Komisioni administroi nga regjistri noterial⁵⁵, provohet pronësia e shtetasit A. B. mbi truallin me sip. 1.465 m², me nr. pasurie ***, me format ligjor të përshkruar në pikën më lart dhe më pas shitja me kontratë shitjeje datë 1.6.2011, blerësit “****” sh.p.k., kundrejt çmimit 27,072,000 lekë. Në këtë kontratë, sipas deklarimit të palëve, çmimi 27,072,000 lekë është likuiduar nga llogaria bankare e blerësit në Raiffeisen Bank në llogarinë bankare të shitësit në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate.

4.14 Drejtoritë Rajonale të ASHK-së Gjirokastër dhe Durrës⁵⁶ konfirmojnë se shtetasi A. B. ka pasur vetëm një apartament me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, Durrës, të cilin e ka blerë⁵⁷ në datën 7.12.1999 dhe e ka shitur⁵⁸ më 4.5.2007 kundrejt çmimit 1,000,000 lekë.

Analiza financiare e burimit të krijimit të kësaj depozite

4.15 Për të provuar përfitimin e shumës 27,072,000 lekë nga vjehri A. B. dhe dhënien e shumës 1,000,000 lekë të bashkëshortit i subjektit, në pyetësonin nr. 3, Komisioni i kërkoi subjektit që të paraqesë dokumente shkresore, ku të evidentohen: (i) kalimi i shumës 27,072,000 lekë nga llogaria e shoqërisë “****” sh.p.k. në Raiffeisen Bank; (ii) tërheqja e shumës 1,000,000 lekë nga llogaria bankare e vjehrit të saj. Në përgjigje, subjekti i rivlerësimit ka depozituar përgjigjen e Raiffeisen Bank⁵⁹ se shtetasi A. B. nuk ka qenë klient i kësaj banke.

4.16 Raiffeisen Bank i ka konfirmuar edhe Komisionit⁶⁰ se shtetasi A. B. nuk ka qenë dhe as nuk është klient i kësaj banke.

4.17 Shoqëria “****” sh.p.k.⁶¹, nëpërmjet nxjerrjes së llogarive të kësaj shoqërie në datën 2.8.2023 nga Raiffeisen Bank, ka konfirmuar kryerjen e dy pagesave prej saj: (i) me vlerë 9,000,150 lekë

⁵⁴ Sipas mandatit datë 13.1.2011 të Raiffeisen Bank dhe pasqyrës llogaritëse të tatimit mbi kalimin e së drejtës së pronësisë, përcjellë nga subjekti në përgjigje të pyetjes nr. 6 të pyetësorit nr. 2.

⁵⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 15.6.2023, të noterit G. K., drejtuar Komisionit, që ka dërguar vërtetim pronësie datë 1.6.2022 dhe hartën e pasurisë lëshuar nga ZVRPP Gjirokastër, si dhe kontratë shitjeje trualli datë 1.6.2011.

⁵⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 23.3.2021, e ASHK Drejtoria Rajonale Durrës dhe shkresë nr. *** prot., datë 24.2.2021, e ASHK Gjirokastër.

⁵⁷ Sipas kontratës së shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.12.1999, noter E. P.

⁵⁸ Sipas kontratës së shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.5.2007, noter M. Rr..

⁵⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 19.7.2023, nga Raiffeisen Bank, bashkëlidhur përgjigjes nr. 5 të pyetësorit nr. 3.

⁶⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 14.7.2023, të Raiffeisen Bank, drejtuar Komisionit.

⁶¹ Shkresë datë 3.8.2023, e shoqërisë “****” sh.p.k. në përgjigje të shkresës nr. *** prot., datë 7.8.2023, të Komisionit.

në datën 3.6.2011; (ii) me vlerë 128,171 euro ose 18,072,111 lekë në datën 3.6.2011 (me kurs këmbimi 141 lekë), për qëllim të ekzekutimit të kontratës së shitblerjes të lidhur në datën 1.6.2011 me shitësin A. B.. Pra, rezulton që shoqëria “****” sh.p.k. ka paguar plotësisht vlerën kontraktore prej 27,072,261 lekësh. Nga përshkrimi i veprimit bankar rezulton që shënohet emri K. B. (djali i A. B.).

4.18 Raiffeisen Bank konfirmon⁶² se shumat 9,000,150 lekë dhe 128,171 euro janë transferuar në datën 3.6.2011 nga llogaria e shoqërisë “****” sh.p.k. në llogarinë e shtetasit K. A. B., me përshkrimin “Likuidim i kontratës pasuri e paluajtshme nr. *** rep., nr. ** kol., shitës A. B. dhe blerës “****” me NIPT ***”.

4.19 Nga të gjitha provat e administruara si më sipër rezulton se janë provuar me dokumentacion shkresor: (i) kryerja e pagesës së vlerës 27,072,261 lekë sipas mënyrës së parashikuar në kontratën⁶³ e lidhur midis shtetasit A. B. dhe shoqërisë “****” sh.p.k.; (ii) tërheqja e shumës 27,072,261 lekë nga djali i A. B., në datën 3.6.2011, nga Raiffeisen Bank, pra para datës 29.6.2011, që është data e krijimit të depozitës së shtetasit E. B. në BKT; (iii) shtetasi A. B. nuk ka pasur llogari në asnjë prej këtyre bankave, prandaj veprimet bankare janë kryer me prokurë të përgjithshme⁶⁴ nga djali i tij K. B.; (iv) shtetasi A. B. ka paguar tatimin mbi të ardhurat nga shitja e truallit në Gjirokastrë, duke i konsideruar kështu të ligjshme këto të ardhura.

4.20 Të gjitha të dhënat si më sipër, Komisioni i vlerëson të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se burimi i krijimit “Dhuratë nga babai i bashkëshortit në shumën 1,000,000 lekë” është i ligjshëm për krijimin e kësaj depozite.

4.21 Nga analiza financiare e kryer për periudhën 1.1.2011 – 29.8.2011⁶⁵ ka rezultuar se subjekti i vlerësimit dhe familja e saj kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e depozitës objekt shqyrtimi, për shkak të një balance pozitive në shumën 116,118 lekë.

4.22 Në këtë analizë është konsideruar si një prej burimeve të krijimit shuma 700,000 lekë, që është deklaruar: (i) në DIPP-në e vitit 2010 si “Kursime nga të ardhurat vjetore”; (ii) në DIPP-në e vitit 2011 si “Pakësim i gjendjes *cash* në shtëpi 700,000 lekë”; (iii) në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti i rivlerësimit ka specifikuar se shuma 700,000 lekë, si gjendje *cash* e mbartur nga viti 2010, është depozituar në llogarinë bankare të bashkëshortit. Këto deklarime janë në të njëjtën linjë me njëra-tjetrën.

4.23 Gjithashtu është shtuar si pjesë e likuiditeteve edhe shuma *cash*-it të ri, e cila është deklaruar në DIPP-në e vitit 2011 si “Kursime nga të ardhurat vjetore 300,000 lekë”. Krijimi i kësaj shume është konsideruar si uniform gjatë 12 muajve të vitit⁶⁶.

4.24 Për sa më lart, Komisioni nuk konstatoi problematika në lidhje me këtë pasuri.

⁶² Shkresë nr. *** prot., datë 12.9.2023, e Raiffeisen Bank, dërguar Komisionit.

⁶³ Kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.6.2011, noter G. K..

⁶⁴ Sipas prokurës së përgjithshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.11.2009, që shtetasi A. B. i ka dhënë djalit të tij K. B., bashkëlidhur shkresa datë 3.8.2023, që shoqëria “****” sh.p.k. ka depozituar pranë Komisionit.

⁶⁵ Për periudhën 1.1.2011 – 29.8.2011, mundësia për kursime ka qenë 116,118 lekë: të ardhura totale të dokumentuara 2,031,349 lekë (nga paga e subjektit 779,737 lekë + nga paga dhe pensioni i bashkëshortit 229,100 lekë + nga paga e djalit 22,512 lekë + dhurim nga babai i bashkëshortit 1,000,000 lekë) minus pasuri prej 1,535,157 lekësh (depozitë bankare në BKT 2,000,000 lekë; shtesa/pakësime likuiditeteve të tjera -464,843 lekë; gjendja e likuiditeteve të tjera 255,815 lekë) minus shpenzime 380,074 lekë (shpenzime jetese 359,329 lekë + shpenzime udhëtimi TIMS 20,745 lekë).

⁶⁶ Pra, deri në datën 29.8.2011, shuma e *cash*-it të ri të krijuar ka qenë 300,000:12 x 8 muaj = 200,000 lekë.

5. - Interesa të përfitur nga depozita në Bankën Kombëtare Tregtare, Durrës, në emër të bashkëshortit të subjektit, z. E. B., në shumën 356,857 lekë (këto të ardhura janë deklaruar edhe nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në deklaratën *Vetting*)

- Gjendja e pagës në Raiffeisen Bank deri në datën 31.12.2016, në emrin e subjektit Anila Bebeçi, deri në datën 25.1.2017, në shumën 1,971.77 lekë

5.1 Në lidhje me këto pasuri, referuar dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit dhe dokumentacionit të administruar⁶⁷ nga BKT Durrës e Raiffeisen Bank, Komisioni arriti në përfundimin se përputhen deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me të dhënat e administruara dhe nuk konstatohen problematika në lidhje me këto pasuri (pasqyrimi i të dhënave për gjendjen e këtyre pasurive referohet në tabelën finale të analizës financiare, pika 13).

❖ Pasuri të deklaruara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. E. B.

6. Automjet tip “Mercedes-Benz 190D”, i vitit 1988, me targë *, blerë në vitin 2002 në shumën 320,000 lekë. Në datën 5.2.2013, mjeti i është shitur shtetasit M. C., sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., të noterisë Gjirokastër, në shumën 160,000 lekë.**

Hetimi i kryer nga Komisioni

6.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën e para fillimit të detyrës të vitit 2003: *“Autoveturë tip “Mercedes-Benz”, me targë ***, regjistruar në emër të bashkëshortit tim... Vlera: 0.5 milion lekë. Burimi i krijimit: kursime familjare. Pjesa takuese: 50%”*, ndërsa në DIPP-në e vitit 2013 ka deklaruar shitjen e automjetit në datën 5.2.2013, në vlerën 160,000 lekë.

6.2 Komisioni vëren se në kohën e deklarimit *Vetting*, kjo pasuri nuk ekziston më në pronësi të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, por meqë të ardhurat nga shitja e saj kanë shërbyer si burim për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz 220D” me targë ***, në datën 13.2.2013, Komisioni hetoi mbi origjinën e pronësisë dhe ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë automjet me targë ***.

6.3 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*: (i) kontratë shitjeje të automjetit, datë 11.5.2002, e lidhur në Gjermani midis blerësit G. D. dhe shitësit A. H., në vlerën 1,300 euro; (ii) vërtetim zhdoganimi datë 26.5.2002, në emër të shtetasit G. D., me vlerë totale 326,032 lekë (1,300 euro çmimi x 130.57 kurs këmbimi + 156,291 lekë taksa doganore); (iii) kontratë shitblerjeje⁶⁸ datë 27.5.2002, e lidhur midis shitësit G. D. dhe blerësit E. B., me çmimin 320,000 lekë; (iv) prokurë e posaçme⁶⁹ datë 28.2.2013, ku shtetasi E. B., me cilësinë e pronarit, emëron si përfaqësues shtetasin M. C., të cilit i jep tagrat që të kryejë të gjitha veprimet për shitjen e mjetit, duke pasur edhe të drejtën e vetëblerjes për llogari të tij; (v) kontratë shitjeje⁷⁰ automjeti, datë 5.2.2013, e lidhur midis shitësit E. B. (përfaqësuar nga M. C. me prokurën e posaçme datë 5.2.2013) dhe blerësit E. C., kundrejt çmimit 160,000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale.

6.4 Komisioni administroi dhe shqyrtoi dosjen e këtij automjeti të dërguar⁷¹ nga DPSHTRR-ja, ku rezulton se ky automjet është regjistruar në datën 3.6.2002 në emër të shtetasit E. B. dhe

⁶⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 13.7.2017, nga Raiffeisen Bank.

⁶⁸ Kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.5.2002, noter M. Rr..

⁶⁹ Prokurë e posaçme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.2.2013.

⁷⁰ Kontratë shitjeje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.2.2013.

⁷¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 23.6.2023, të DPSHTRR-së.

dokumentacioni i kësaj dosjeje është i njëjtë me atë që subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*.

6.5 Nga hetimi për konflikt interesi midis subjektit të rivlerësimit dhe shitësit të automjetit G. D., nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë⁷².

Analiza financiare e burimit të krijimit të kësaj pasurie

6.6 Komisioni analizoi mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit për të blerë automjetin në shumën 320,000 lekë, në datën 27.5.2002, bazuar në deklaratimet e saj në pyetësin nr. 1 se burim për krijimin e tij këtij automjeti janë kursimet familjare.

6.7 Nga kjo analizë ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e këtij automjeti në periudhën 8.9.1999 – 27.5.2002, pasi kanë mundur të kursejnë shumën 183,812 lekë⁷³.

6.8 Kjo analizë është kryer duke përdorur metodologjinë kumulative. Periudha e analizuar është nga data 8.9.1999, pra pas blerjes së apartamentit në Durrës dhe deri në datën e blerjes së automjetit. Janë përfshirë të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe kursimet e mbartura nga periudha e kaluar⁷⁴.

6.9 Për sa më sipër, Komisioni arriti në përfundimin se përputhet deklarimi i subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e administruar dhe nuk ka problematika në lidhje me deklarimin dhe burimin e krijimit të kësaj pasurie.

7. Automjet tip “Mercedes-Benz 220D”, me targë *, blerë në datën 13.2.2013, në shumën 4,000 euro shtetasit A. L., sipas kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol. Vlera: 560,000 lekë. Në datën 10.1.2015, automjeti me targë *** i është shitur autoshtetës **** me vlerë 150,000 lekë sipas kontratës së shitblerjes nr. *** kol., nr. *** rep.**

Hetimi i kryer nga Komisioni

7.1 Në DIPP-në e vitit 2013, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë deklaruar blerjen e automjetit më 13.2.2013, me vlerë 560,000 lekë.

7.2 Në DIPP-në e vitit 2016, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar shitjen e këtij automjeti në datën 10.1.2015 autoshtetës ****, me vlerë 150,000 lekë.

7.3 Nga hetimi për konflikt interesi midis subjektit të rivlerësimit dhe shitësit të automjetit A. L. nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë⁷⁵.

⁷² Me shkresën nr. *** prot., datë 29.6.2023, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

⁷³ Për periudhën 8.9.1999 – 27.5.2002, mundësia për kursime ka qenë 183,812 lekë: të ardhura totale të dokumentuara 1,664,119 lekë (nga paga e subjektit 1,199,072 lekë + kursime të mbartura nga periudha të kaluara 465,047lekë) minus pasuri prej 320,000 lekësh (blerë Mercedes-Benz 190D, me targë ***) minus shpenzime 1,160,307 lekë (shpenzime jetese 1,069,107 lekë + shpenzime mobilimi sipas deklaratimeve të subjektit 48,000 lekë + shpenzime transporti të brendshëm 16,200 lekë + shpenzime për shkollimin e vajzës 27,000 lekë).

⁷⁴ Kjo shumë përfaqëson “Mundësia për kursime kumulative” që ka rezultuar nga analiza financiare e subjektit për vitet 1993-8.9.1999.

⁷⁵ Me shkresën nr. *** , datë 29.6.2023 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

7.4 Referuar dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit⁷⁶ në deklaratën *Vetting* dhe atij të administruar nga DPSHTRR-ja⁷⁷, Komisioni vëren se ky automjet nuk është më në pronësi të subjektit gjatë kohës së deklarimit *Vetting*, por transaksionet për blerjen e shitjen e tij janë të ligjshme dhe efekti financiar i tyre është pasqyruar në analizën financiare në pikën 13 të vendimit.

7.5 Sa i takon mundësisë financiare për blerjen e këtij automjeti, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e tij në shumën 4,000 euro, në datën 13.2.2013, duke përdorur si burime: (i) të ardhurat nga shitja e automjetit me targë *** në vlerën 160,000 lekë⁷⁸; (ii) një pjesë nga shuma *cash* e mbartur nga viti i kaluar⁷⁹, sikurse ka deklaruar subjekti i rivlerësimit në pyetësonin standard.

7.6 Për sa më sipër, Komisioni arriti në përfundimin se përputhet deklarimi i subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e administruar dhe nuk ka problematika në lidhje me këtë pasuri.

8. Gjendja e pagës tek Alpha Bank deri në datën 26.1.2017, në vlerën 232.86 lekë

8.1 Referuar dokumentacionit që subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* dhe atij të administruar nga Alpha Bank⁸⁰, Komisioni arriti në përfundimin se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar dhe nuk ka problematika në lidhje me këtë pasuri.

❖ Pasuri të deklaruara nga djali i subjektit të rivlerësimit E. B.

9. Automjet tip “Volkswagen”, prodhim i vitit 2002, me targë *, blerë në datën 5.12.2011, me vlerë 500,000 lekë**

Burimi i krijimit: kursimet nga pagat e prindërve.

Hetimi i kryer nga Komisioni

9.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2011 blerjen e automjetit me targë ***, në emër të djalit të saj, në datën 5.12.2011, me vlerë 500,000 lekë, por nuk ka deklaruar burim krijimi, ndërsa në pyetësonin standard ka deklaruar si burim krijimi “Kursimet familjare”.

9.2 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*: (i) kontratë shitjeje të automjetit tip “Volkswagen Golf”, viti 2002, datë 22.11.2011, e lidhur në Gjermani midis shitësit A. B. dhe blerësit E. B., me çmim 1,200 euro; (ii) deklaratë zhdoganimi të automjetit datë 6.12.2011, me vlerë totale + zhdoganimi 205,556 lekë (1,200 euro çmimi x 139.74⁸¹ + 37,868 lekë taksë zhdoganimi); (iii) certifikatë pronësie dhe leje qarkullimi datë 14.12.2011, e automjetit me targë ***, në pronësi të djalit E. B.

⁷⁶ (i) Kontratë shitblerjeje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.2.2013, e lidhur midis shitësit A. L. dhe blerësit E. B. për shitjen e automjetit tip “Mercedes-Benz C200 CDI”, kundrejt çmimit 4,000 euro; (ii) deklaratë datë 25.1.2013, e zhdoganimit të automjetit nga shtetasi A. L., me vlerë totale 111,672 lekë; (iii) kontratë shitblerjeje nr. *** kol., nr. *** rep., datë 10.1.2015, e lidhur midis shitësit E. B. dhe blerësit, autoshkolla “****” (me përfaqësues ligjor, ortakun dhe administratorin e vetëm M. C.) për shitjen e automjetit tip “Mercedes-Benz C200 CDI”, me targë ***, kundrejt çmimit 150,000 lekë; (iv) leje qarkullimi datë 14.1.2015, në emër të shtetasit M. C..

⁷⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 23.6.2023, të DPSHTRR-së.

⁷⁸ Mundësia për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz 190D”, me targë *** është analizuar në pikën 6.7 të rezultateve.

⁷⁹ Subjekti ka deklaruar kursime nga pagat në shumën 700,000 lekë në fund të vitit 2012 dhe mundësia për t’i krijuar këto kursime është treguar në tabelën përfundimtare në pikën 13 të rezultateve.

⁸⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 2.8.2017, e Alpha Bank.

⁸¹ Kursi i këmbimit 1 euro = 139.74 lekë, sikurse evidentuar në deklaratën doganore.

9.3 Komisioni administroi dhe shqyrtoi dosjen e këtij automjeti të dërguar⁸² nga DPSHTRR-ja, ku rezultuan të njëjtat dokumente që subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*.

9.4 Nga dokumentacioni si më sipër rezultoi se shtetasi E. B. e ka blerë automjetin tip “Volkswagen” me targë ***, në vlerë totale 205,556 lekë. Për sa më lart, duket se të dhënat nga ky dokumentacion i administruar nga Komisioni nuk përputhen me deklaratimet e subjektit dhe djalit të saj në DIPP-në e vitit 2011, në deklaratën *Vetting* dhe në pyetësin standard, ku ata kanë deklaruar se automjeti është blerë në datën 5.12.2011, me çmimin 500,000 lekë.

9.5 Në lidhje me këto mospërputhje, subjekti ka sqaruar në pyetësin nr. 4 se kontrata e automjetit datë 22.11.2011 është lidhur në Gjermani nga një tregtar automjetesh me emrin G. D., por e hartuar në emër të djalit të saj, pra nuk është blerë nga djali i saj në Gjermani, por nga shtetasi G. D., me të cilin ata kanë njohje dhe meqenëse ai merret me shitblerje automjetesh nga Gjermania në Shqipëri i kanë kërkuar të sillte një automjet. Këtij shtetasi i është dhënë në mirëbesim karta e identitetit të djalit E. B. në mënyrë që blerja të kryhej menjëherë në emër të djalit. Vlera pas zhdoganimit është 205,556 lekë, që është vlera me të cilën shtetasi G. D. e ka blerë në Gjermani. Pasi e ka sjellë automjetin në Shqipëri, u pagua shuma 500,000 lekë për ta blerë atë, pasi kjo ishte shuma që iu kërkua.

9.6 Komisioni hetoi në sistemin TIMS, nga ku rezultoi se shtetasi E. B. nuk ka hyrë dhe as ka dalë nga territori i Shqipërisë në datat 5.12.2011 dhe 21.11.2011.

9.7 Nga verifikimi i dokumentacionit nga DPSHTRR-ja rezulton se kontrata e shitblerjes mban emrin E. B. në cilësinë e blerësit dhe në deklaratën doganore si zhdoganues është shënuar importues individual automjetesh.

9.8 Siç është cituar edhe më lart, nga hetimi⁸³ nuk rezultoi ndonjë situatë konflikti interesi midis subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit G. D..

9.9 Nisur nga shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në pyetësin nr. 4, ndër të tjera, duket se çmimi është paguar prej tij pasi automjeti ka hyrë dhe është zhdoganuar në Shqipëri në datën 5.12.2011, në vlerën 500.000 lekë, vlerë e cila është konsideruar në analizën financiare.

Analiza financiare e burimit të krijimit të kësaj pasurie

9.10 Komisioni ka kryer analizën financiare në momentin e blerjes së automjetit në datën 5.12.2011 dhe në vlerën 500,000 lekë, sikurse deklaruar nga djali i subjektit në deklaratën *Vetting*. Kjo analizë është shtrirë në periudhën 29.8.2011⁸⁴, datë kur është krijuar depozita e bashkëshortit në BKT⁸⁵, deri në datën e blerjes së automjetit, 5.12.2011.

9.11 Nga analiza e kryer, sipas tabelës më poshtë, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti⁸⁶ i saj kanë pasur mungesë të ardhurash të ligjshme në shumën -167,704 lekë, për të blerë automjetin e djalit me targë ***.

⁸² Me shkresën nr. *** prot., datë 23.6.2023, të DPSHTRR-së.

⁸³ Me shkresën nr. *** prot., datë 29.6.2023, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

⁸⁴ Për të shmangur mbivendosjen me krijimin e depozitës.

⁸⁵ Trajtuar në pasurinë nr. 4 të këtij vendimi.

⁸⁶ Në këtë analizë nuk janë përfshirë të ardhura të bashkëshortit nga autoshkolla “****”, trajtuar në rubrikën “Konstatime të tjera”, pika 12.

Tabela nr. 3

Përshkrimi	Nga 29/8 deri më 5.12.2011
Pasuri	584,308
Blerë Volkswagen *** nga djali i subjektit	500,000
<i>Shtesa/pakësime likuiditeteve</i>	<i>84,308</i>
Gjendja e likuiditeteve	2,340,123
Të ardhura dokumentuar	688,073
Të ardhura nga paga e subjektit	389,869
Të ardhura nga paga dhe pensioni i bashkëshortit	114,550
Të ardhura nga djali E. sipas BKT-së	67,536
Kursime të mbaruara nga periudha 1 janar – 29.8.2011	116,118
Shpenzime	271,469
Shpenzime jetese	146,726
Shpenzime udhëtimi TIMS	16,742
Shpenzime për shkollimin e fëmijëve	108,000
Mundësia për kursime	-167,704

9.12 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i ngarkoi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit në lidhje me mungesën e të ardhurave të ligjshme në shumën 167,704 lekë për blerjen e automjetit të djalit me targë ***.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit ndaj barrës së provës

9.13 Në parashtrime, subjekti i rivlerësimit deklaroi se ajo dhe familja e saj kanë pasur mundësi financiare për blerjen e këtij automjeti, por rezultati i Komisionit ka ardhur nga mospërfshirja në analizën financiare e të ardhurave nga puna e bashkëshortit.

Vlerësimi i Komisionit

9.14 Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka vlerësuar se të ardhurat e bashkëshortit E. B. për vitin 2011 nuk ndryshojnë. Në analizën financiare janë përfshirë të ardhurat e dokumentuara, në masën që ato kalojnë në llogarinë bankare të bashkëshortit E. B. tek Alpha Bank. Të ardhurat e bashkëshortit janë trajtuar hollësisht në rubrikën “Konstatime të tjera” pika 11 e këtij vendimi.

9.15 Në përfundim, Komisioni vlerëson se mungesa e fondeve për blerjen e automjetit në dhjetor të vitit 2011, në shumën -167,704 lekë, nuk arrin deri në atë nivel sa të përbëjë shkak për penalizimin e subjektit të rivlerësimit në lidhje me vlerësimin e kriterit të pasurisë.

10. Llogari page në Intesa Sanpaolo Bank, me gjendje 700,71 lekë në datën 26.1.2017 dhe me gjendje 25.700,71 lekë në datën 31.12.2016

10.1 Kjo llogari është deklaruar nga djali i subjektit E. B. edhe në DIPP-në e vitit 2016.

10.2 Referuar dokumentacionit që subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*⁸⁷, si dhe informacionit nga Intesa Sanpaolo Bank⁸⁸, Komisioni arriti në përfundimin se përputhet

⁸⁷ (i) Lëvizjet e llogarisë në emër të djalit E. B. në Intesa Sanpaolo Bank (ISP Bank) për periudhën 1.1.2016 – 31.12.2016, ku rezultojnë se për këtë periudhë është kredituar në llogarinë e tij paga mujore nga punëdhënësi M. L., si dhe pasqyrohet gjendja e llogarisë në emër të tij në datën 31.12.2016, në shumën 25,700 lekë; (ii) lëvizjet e llogarisë, ku deri më 26.1.2017 është 700 lekë.

⁸⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 13.7.2017, nga Intesa Sanpaolo Bank.

deklarimi i subjektit të rivlerësimit me këtë dokumentacion dhe nuk ka problematika për këtë pasuri.

KONSTATIME TË TJERA

11. Në tabelën më poshtë janë pasqyruar në mënyrë të përmbledhur deklaratimet e likuiditeteve të krijuara nga kursimet, sipas deklaratave periodike vjetore.

Tabela nr. 4

Likuiditete deklaruar në DIPP (lekë)			Likuiditete të deklaruar në pyetësin nr. 3	Gjendja 31 dhjetor e konsideruar nga Komisioni në rezultatet e hetimit		Gjendje cash Vendimi i Komisionit
Vitet	Me shifra	Me fjalë		Bankë	Cash	
2004	-	-	200.000	-	-	200 000
2005	-	-	+100.000		-	300 000
2006	-	-	+500.000		-	800 000
2007	800 000 -800 000 300 000	Deri në datën 31.12.2006 nga të ardhurat e mia familjare kam kursyer gjendje cash 800,000 lekë. Pakësuar gjendje cash për blerjen e apartamentit. Vlera 300,000 lekë. Pjesa 100%.	-800.000 për apartamentin +300.000 në fund 2007	-	300 000	300 000
2008	-	-	-	-	-	
2009	-	-	-	-	-	
2010	700 000	Kursimet nga të ardhurat vjetore	700.000 në fund 2010		700 000	700 000
2011	300 000	Pakësimi i gjendjes cash në shtëpi 700.000 lekë. Kursime nga të ardhurat vjetore 300.000	-700.000 nga viti 2010 tek llogaria bankare e bashkëshortit. +300.000 lekë cash në fund të vitit 2011	700 000	300 000	300 000
2012	700 000	Kursimet nga pagat	Nga cash-i i vitit të kaluar -100.0000 lekë te llogaria e djalit -200.000 lekë për nevoja të ndryshme familjare 500.000 lekë cash në fund të vitit 2012	100 000	500 000	500 000

2013	-		<i>Kursimet e vitit 2012 janë përdorur për blerjen e makinës në vitin 2013. 0 cash në fund të vitit 2013</i>	-	-	-
2014	1 200 000	<i>Kursime nga pagat</i>	<i>0 cash në fund të 2014. Kursimet janë derdhur në llogarinë e djalit</i>	1 200 000	-	-
2015	900 000	<i>200.000 lekë kursime nga paga (cash). Kursimet nga pagat 900.000 lekë</i>	<i>200.000 lekë cash në fund të vitit 2015. Të tjerat (nga 900 mijë) derdhur në llogarinë e djalit</i>	700 000	200 000	200 000
2016	-	-	<i>0 cash në fund të vitit 2016. -200.000 lekë nga viti 2015, shpenzuar për shtëpinë</i>		-	-
Deklarata Vetting	-	-				

11.1 Për shkak se nga deklaratimet e mësipërme likuiditetet e deklaruara si “Kursime nga pagat” nuk ishin të specifikuar nëse ishin gjendje *cash* apo ndonjë formë tjetër likuiditeti, si dhe në rast se janë, çfarë përfaqësojnë ato, ndryshime (shtesa ose pakësime) apo gjendje *cash* në pyetësonin nr. 3, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të sqarojë: (i) gjatë cilës periudhë janë krijuar kursimet *cash* prej 800,000 lekësh të deklaruara prej saj në DIPP-në e vitit 2007 dhe sa ka qenë shuma e kursyer për çdo vit; (ii) çfarë përfaqëson secila prej dy shumave të deklaruara në vitin 2015 si “Kursime nga pagat”, nga të cilat njëra është specifikuar si “*cash*”; (iii) të përcaktojë qartësisht gjendjen e kursimeve *cash* në datën 31 dhjetor të çdo viti; (iv) nëse kursimet *cash* të deklaruara janë shpenzuar, kur dhe për çfarë janë shpenzuar.

11.2 Në përgjigje, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar:

i) Kursimet *cash* 800,000 lekë, të deklaruara në datën 31.12.2006, janë mbledhur që nga viti 2004, kur nga të ardhurat e saj dhe të bashkëshortit në datën 31.12.2004 ka pasur 200,000 lekë *cash*, për vitin 2005 të ardhurat *cash* janë shtuar me 100,000 lekë dhe për vitin 2006 ka kursyer edhe 500,000 lekë të tjera. Prandaj, në fund të vitit 2006, vlera e kursyer *cash* është 800,000 lekë.

ii) Të ardhurat vjetore për vitin 2015 janë 2,058,389 lekë, nga të cilat 900,000 lekë janë kursime vjetore totale nga të ardhurat, nga të cilat rreth 700,000 lekë janë derdhur në llogarinë e djalit si kursime familjare, ndërsa pjesa e mbetur 200,000 lekë *cash* qëndroi gjendje në shtëpi. Pra, shumat 900,000 lekë dhe 200,000 lekë nuk janë dy shuma të ndara, por nga shuma totale 900,000 shuma 200,000 lekë që nuk është hedhur në bankë është deklaruar *cash*.

iii) Në lidhje me gjendjen e kursimeve *cash*, në datën 31 dhjetor të çdo viti, subjekti ka sqaruar:

- 31.12.2004 kursime *cash* 200,000 lekë.

- 31.12.2005 kursime *cash* 100,000 lekë.
- 31.12.2006 kursime vjetore 500,000 lekë me gjendje totale 800,000 lekë.
- Në vitin 2007 vlera *cash* 800,000 lekë është përdorur për blerjen e apartamentit, në datën 31.12.2007 ka kursyer nga të ardhurat edhe 300,000 lekë.
- 31.12.2010 kursime *cash* 700,000 lekë nga të ardhurat familjare.
- 31.12.2011 shuma 700,000 lekë *cash*, e deklaruar në vitin paraardhës së bashku me të ardhurat nga pagat e vitit 2011, është depozituar në llogarinë e bashkëshortit. Nga kursimet e tjera, në fund të vitit është blerë automjeti i djalit 500,000 lekë dhe në datën 31.12.2011 gjendja *cash* është 300,000 lekë.
- Në fillim të vitit 2012, nga gjendja *cash* 300,000 lekë janë depozituar në llogarinë e djalit 100,000 lekë. Diferenca e mbetur prej 200,000 lekësh është shpenzuar për nevoja familjare. Në datën 31.12.2012, gjendja *cash* nga kursimet vjetore është 500,000 lekë, të cilat janë përdorur për blerjen e automjetit në vitin 2013.
- Në datat 31.12.2013 dhe 31.12.2014 nuk ka gjendje *cash*, pasi kursimet e mbledhura nga të ardhurat vjetore janë derdhur në llogarinë e djalit.
- Në datën 31.12.2015 ka pasur gjendje *cash* 200,000 lekë, pasi nga të ardhurat vjetore ka kursyer në total 900,000 lekë. Shuma 200,000 lekë, që nuk është derdhur në llogari, është ruajtur *cash* në shtëpi.
- Në datën 31.12.2016 nuk ka gjendje *cash*, sepse shuma *cash* e vitit paraardhës është shpenzuar për shtëpinë.

11.3 Në konkluzion të sa më sipër, në lidhje me deklarimin e likuiditeteve në DIPP-të vjetore, përveç viteve 2004 – 2006, për të gjitha deklaramet e tjera duket se: (i) subjekti ka deklaruar çdo vit në rubrikën e deklarimit të pasurive “Kursime nga paga/kursime nga të ardhurat e vitit”, çka tregon se ajo ka deklaruar likuiditetet e kursyera; (ii) deklaramet janë uniforme, çka tregon se kjo ka qenë mënyra se si subjekti e ka kuptuar deklarimin e likuiditeteve; (iii) sqarimet e subjektit në pyetësorin nr. 3 janë në të njëjtën linjë dhe mbështesin deklaramet e saj ndër vite; (iv) këto saktësime sqarojnë edhe ku janë përdorur kursimet nga paga, të cilat përkojnë me transaksionet financiare të subjektit dhe familjarëve të saj; (v) shumat *cash* janë gjendje dhe jo ndryshime të tij.

11.4 Për këto arsye, Komisioni ka vlerësuar të konsiderojë gjendjen *cash* dhe likuiditetet në bankë, sikurse treguar në dy kolonat e fundit të tabelës më lart të pikës 11 të këtij vendimi.

11.5 Në lidhje me gjendjen *cash* të krijuar gjatë viteve 2004 – 2006, në përfundim të procesit, Komisioni çmoi të pranojë prapësimet e subjektit si të bazuara në fakte dhe argumente. Prapësimet e subjektit dhe qëndrimi i Komisionit për këtë çështje janë trajtuar hollësisht në pikat 1.36 - 1.37 dhe 1.39 të këtij vendimi.

12. Nga DIPP-të e subjektit të rivlerësimit është evidentuar se në periudhën 2005 – 2011 janë deklaruar periodikisht të ardhura të bashkëshortit të saj

12.1 Në lidhje me këto të ardhura, Komisioni kreu hetimin, nga ku rezultoi se punëmarrësi E. B. (bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit) ka lidhur kontratë pune në datën 5.1.2005 me punëdhënësin, shoqëria “***” sh.p.k. dhe është punësuar si instruktor i autoshkollës për një afat 5-vjeçar, kundrejt pagës 30,000 lekë/muaj. Në kontratë, palët kanë përcaktuar se *përballojnë shpenzimet për sigurimet shoqërore e shëndetësore sipas koeficientit përpjesëtimor të caktuar në*

ligj. Gjithashtu, ka rezultuar se që nga marsi i vitit 2011 e në vijim shtetasi E. B. i kalon paga në Alpha Bank, nga ku rezulton se ai paguhet me pagë minimale (më të ulët se 30,000 lekë).

12.2 Autoshkolla “***” sh.p.k. konfirmon se⁸⁹ shtetasi E. B. ka punuar dhe ka përfituar të ardhura nga viti 2005 deri në fund të vitit 2011, sipas tabelës më poshtë.

12.3 Sipas të dhënave nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Durrës⁹⁰ vërtetohen të ardhura për periudhën maj 2003 – mars 2004 si i punësuar pranë Bashkisë Durrës; mars 2011 – dhjetor 2014 i punësuar pranë shoqërisë “***” sh.p.k. si instruktor autoshkolle.

12.4 Sa më sipër, janë paraqitur në një formë të përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 5

Paga në lekë	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	Total
Paga e deklaruar në DIPP/vërtetim punëdhënësi	600,000	600,000	600,000	800,000	850,000	700,000	600,000	4,750,000
Paga sipas kontratave	360,000	360,000	360,000	360,000	360,000			1.800,000

12.5 Në pyetësin nr. 3, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të paraqesë dokumentacionin që provon: (i) pagesën e tatimit mbi të ardhurat e bashkëshortit të saj për këto vite; (ii) llogaritë bankare, ku të evidentohen hyrjet e pagave mujore.

12.6 Në përgjigje, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se në lidhje me pagesën e tatimit mbi të ardhurat, referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, i ndryshuar me ligjin nr. 10343, datë 28.10.2010, bashkëshorti i saj E. B. nuk ka qenë subjekt i detyrimit të tatimit mbi të ardhurat personale dhe plotësimi i deklaratave vjetore të të ardhurave personale ka hyrë në fuqi në vitin 2011. Detyrimi për tatimin ka qenë i shoqërisë “***” sh.p.k. dhe subjekti nuk ka mundësi të kontrollojë nëse kjo shoqëri e ka shlyer këtë detyrim.

12.7 Bashkëlidhur përgjigjes, subjekti i rivlerësimit ka depozituar: (i) aneks kontratën datë 5.2.2005, të lidhur midis punëmarrësit E. B. dhe punëdhënësit autoshkolla “***” për 5 vjet, ku palët janë dakordësuar që punëmarrësi E. B., si instruktor autoshkolle pranë punëdhënësit, përveç pagës mujore të përcaktuar në kontratën e punës datë 10.1.2005, do të paguhet edhe me 30,000 lekë/muaj për shkak se do të përdorë automjetin e vet tip “Mercedes-Benz”, me targë ***, në funksion të punës si instruktor; (ii) deklaratën nga shtetasi M. C., i cili deklaroi se gjatë periudhës prill 2003 – 2021 shtetasi E. B. ka qenë i punësuar si instruktor autoshkolle me automjetin e vet (në zbatim të udhëzimit nr. ***, datë 25.3.2003, të DPSHTRR-së⁹¹) në shoqëritë që ka krijuar M. C.⁹². Në lidhje me pagesën e tatimit mbi të ardhurat e realizuara nga shtetasi E. B. për periudhën 2005 – 2011, deklaruesi jep të njëjtin shpjegim si subjekti i rivlerësimit në përgjigjen e pyetësit

⁸⁹ Sipas dy vërtetimeve⁸⁹ datë 20.1.2017, administruar në dosjen e ILDKPKI-së.

⁹⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 4.7.2023, nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Durrës.

⁹¹ Vërtetim që subjekti i rivlerësimit e ka përcjellë në pyetësin nr. 3, ku gjithashtu citohet se deri në vitin 2014 autoshkollat, bazuar në udhëzimin e DPSHTRR-së nr. ***, datë 25.3.2003, mund të merrnin automjetet në pronësi apo në përdorim, ndërsa pas vitit 2014 vetëm në pronësi. Ky ka qenë edhe shkak që z. E. B., deri në vitin 2014 ka punuar së bashku me automjetin e tij dhe pas vitit 2014 e ka shitur këtë mjet tek Autoshkolla, deri kur është larguar nga puna. Me largimin nga puna ky automjet është rikthyer sërish në pronësi të tij, sipas kontratave të lidhura midis palëve.

⁹² Në prill të vitit 2003 ka krijuar shoqërinë “***” sh.p.k., me objekt “Autoshkolle”, e cila në vitin 2010 është përthithur nga shoqëria “***”, ndërsa në janar të vitit 2015 ka krijuar autoshkollën “C.”.

nr. 3 (shihni pikën 12.6 më lart), si dhe shton se pagesat e pagave janë bërë në dorë dhe jo me bankë.

12.8 Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të provojë pagesën e tatimit mbi të ardhurat e bashkëshortit dhe as kalimin e pagave mujore në llogaritë bankare të bashkëshortit të saj, çka bën që këto të ardhura të mos konsiderohen të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016. Për këto arsye, të ardhurat e deklaruara si të përfituara gjatë periudhës 2005 – mars 2011 nuk janë përfshirë në analizën financiare.

12.9 Në prapësimet e barrës së provës, subjekti i rivlerësimit e ka kundërshtuar këtë konstatim paraprak të Komisionit dhe për të mbështetur kundërshtimet e saj ka paraqitur disa argumente: (i) këto të ardhura janë deklaruar prej saj në çdo deklaram periodik vjetor, nga viti 2005 deri në vitin 2011, me përshkrimin “Të ardhura nga puna e bashkëshortit si instruktor pranë autoshkollës “****”, Durrës”; (ii) bashkëshorti i saj ka qenë i punësuar për disa vite me radhë me automjetin e tij dhe ka përfituar të ardhura nga viti 2005 deri në fund të vitit 2010 (sipas tabelës së paraqitur nga Komisioni), vërtetuar me kontratën e punës datë 10.1.2005, aneksin e kësaj kontrate, deklaratën jonoteriale të administratorit dhe pronarit të vetëm të shoqërisë “*****” sh.p.k., si dhe me vërtetimin datë 20.1.2017, lëshuar nga autoshkolla “****” sh.p.k.; (iii) ligji nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, që ka qenë në fuqi gjatë marrëdhënies së punës së bashkëshortit të saj, nenet 6, 8 dhe 11 përcaktojnë detyrimin e punëdhënësit që të llogarisë e të mbajë nga paga e punëmarrësit kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat nga paga, si dhe t’i derdhë ato së bashku me kontributin e vet në organet tatimore ose në llogaritë e Institutit të Sigurimeve Shoqërore; (iv) sa i takon pagesës së tatimit mbi të ardhurat, ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, nenet 8/a, 9, 10, si dhe Udhëzimi nr. ***, datë 30.1.2006, i ministrit të Financave “Për tatimin mbi të ardhurat”, i dalë në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, në pikën 2.6.1 përcaktojnë detyrimin e çdo punëdhënësi për të llogaritur dhe mbajtur në burim tatimin mbi të ardhurat personale, që janë pagat e shpërblimet e tjera, dhe ta derdhi këtë tatim në favor të organeve tatimore jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës. Kodi i Punës ka parashikuar në mënyrë eksplicite se deklaramin në listëpagesë dhe pagesën e sigurimeve shoqërore e shëndetësore e ka si detyrim vetëm punëdhënësi. Gjithashtu, referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar me ligjin nr. 10343, datë 28.10.2010, bashkëshorti i saj nuk ka qenë subjekt i detyrimit të të ardhurave personale dhe se plotësimi i deklaratave vjetore të të ardhurave personale ka hyrë në fuqi në vitin 2011; (v) sjellë në vëmendje të Komisionit edhe praktikën e konsoliduar të Kolegjit, duke komentuar 5 vendime të tij në lidhje me pagesën e tatimit mbi të ardhurat, dhe konkretisht:

a) Vendimi nr. 20, datë 14.7.2021, i Kolegjit (pika 32), në të cilin pretendimet për pagesë të mëvonshme gjatë procesit të rivlerësimit të detyrimit tatimor nuk janë marrë në konsideratë nga trupi gjyqësor, për sa kohë nga aktet e administruara në fashikullin e Komisionit nuk u konstatua asnjë fakt, i cili të provonte se mospagesa e tatimit për vlerën e plotë të përfituar nga shitja e pasurisë së paluajtshme ishte “jo për faj të subjektit të rivlerësimit”. Referuar këtij vendimi të Kolegjit, subjekti i rivlerësimit shpjegoi në prapësime se rezultoni e provuar që

pagesa e kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, si dhe pagesa për detyrimin e tatimit mbi të ardhurat personale nuk është shmangur për faj të bashkëshortit të saj.

- b) Vendimi nr. 14, datë 15.6.2021, i Kolegjit (pikat 70 - 71). Në përmbledhje të pikës 70 të këtij vendimi, Kolegji ka vlerësuar se nuk sjell asnjë efekt në vlerësimin e ligjshmërisë së të ardhurave të krijuara nga subjekti i rivlerësimit me burim qiranë, për sa kohë e ardhura që qiramarrësi (individ) ka përfituar nga qiraja (që ka marrë nga një person juridik) është zvogëluar me vlerën e detyrimit tatimor që përcakton ligji dhe për sa kohë pagimi i kësaj shume në buxhetin e shtetit nuk është detyrim i tij. Për më tepër që legjislacioni tatimor parashikon edhe sanksione administrative për personat juridikë si agjentë të mbajtjes së tatimit, kur pas llogaritjes dhe mbajtjes së tatimit nuk e paguajnë atë në llogarinë e buxhetit të shtetit.
- c) Vendimi nr. 15, datë 18.6.2021, i Kolegjit (pika 23), ku në referim të nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 orientohet të bëhet legjitimimi i të ardhurave të krijuara nëse paguhen me vonesë detyrimet tatimore, duke konsideruar disa rrethana: *së pari*, provueshmëria në mënyrë bindëse e ekzistencës së të ardhurave në kohën e krijimit të tyre; *së dyti*, të mbahet në konsideratë të organeve të rivlerësimit sjellja e subjektit apo e personave të lidhur dhe e personave të tjerë të lidhur në raport me mospagimin në kohë të tyre, si dhe të vlerësohen rrethanat që kanë shkaktuar mospagimin në kohë të detyrimit, për të përcaktuar nëse mospagimi ka qenë pasojë e ndonjë pakujdesie, paqartësie apo një qëllim për t'u arritur. Në çdo rast, këto të ardhura nuk mund të legjitimohen nëse subjektet, personat e lidhur apo personat e tjerë të lidhur kanë qenë në kushte keqbesimi, në kufijtë e kryerjes së një vepre penale.
- d) Vendimi nr. 6, datë 17.3.2022, i Kolegjit (pika 17.4.), ku në analizë të parashikimeve ligjore të nenit 33, pika 1, shkronja “ë” e ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat personale”, i ndryshuar, çmon se referuar faktit se pala qiramarrëse ka qenë person juridik në kohën e ekzistencës së marrëdhënies dhe përfitimit të këtyre të ardhurave, ajo ka pasur edhe detyrimin për mbajtjen në burim të vlerës së tatimit mbi të ardhurat. Në këto rrethana, për sa kohë që detyrimi i përket një personi tjetër dhe jo subjektit të rivlerësimit dhe nuk ka dyshime për ekzistencën/përfitimin e këtyre të ardhurave nga një burim i ligjshëm, ngarkimi me përgjegjësi i subjektit sipas ligjit nr. 84/2016, edhe në rast të mosshlyerjes së detyrimeve tatimore nga subjekte të tjera të së drejtës, nuk duket se vjen në harmoi me qëllimin dhe kërkesat e ligjit, i cili konsideron të ardhura të ligjshme ato të deklaruara dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, kur këto detyrime i takojnë subjektit të rivlerësimit, personave të lidhur apo të tjerë të lidhur me të. Kolegji konfirmon qëndrimin e tij të mbajtur edhe në çështje të mëparshme⁹³, që për sa kohë të ardhurat janë deklaruar rregullisht në deklaratën e pasurisë *Vetting* dhe në ato periodike, dhe provohet se ekzistojnë dhe vijnë pikërisht nga burimi i deklaruar si i tillë prej subjektit, në rast se mosprovueshmëria e pagimit të detyrimeve tatimore i përket subjektit tjetër dhe se subjekti nuk ka dijeni apo një sjellje bashkëpunuese në këtë drejtim, duhet të kalojnë testin e nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016.
- e) Vendimi nr. 35, datë 22.9.2022, i Kolegjit (pika 74), ku është shprehur se: “...trupi gjykues vlerëson se pavarësisht se nga hetimi rezultoi që për një pjesë të të ardhurave të krijuara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nuk janë përmbushur detyrimet tatimore të

⁹³ Vendimi nr. 15, datë 18.6.2021, subjekti i rivlerësimit K. S.; vendimi nr. 14, datë 15.6.2021, subjekti i rivlerësimit I. B.

parashikuara nga legjislacioni në fuqi, fakti që ky detyrim, referuar parashikimeve të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bie mbi palën punëdhënëse, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk mund të penalizohen në kuadër të procesit të rivlerësimit, në drejtim të vlerësimit të ligjshmërisë së të ardhurave të realizuara nga punësimi, për sa kohë nuk provohet që mospërbushja e detyrimeve të palës punëdhënëse ka qenë e ditur dhe rrjedhimisht e pranuar nga punëmarrësi. Në kuadër të vlerësimit të qenies apo jo në mirëbesim të punëmarrësit lidhur me pagesat e detyrimeve që lindin nga paga, trupi gjykues mbajti në konsideratë faktin që pagesat janë kryer në tërësinë e tyre, në masën e pretenduar, nëpërmjet sistemit bankar, sikundër edhe se vërtetimet e vazhdueshme të marra nga z. F. Sh. nga punëdhënësit e tij, për efekt dokumentacioni, konfirmonin pagën e pretenduar prej tij, çka vlerësohet nga trupi gjykues se personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit nuk ka qenë në kushtet për të vënë në dyshim se lidhur me pagesat e përfituara nga punësimi i tij, nuk ishin shlyer nga punëdhënësit detyrimet me natyrë tatimore ndaj shtetit. Në përfundim të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues vlerëson se konkluzioni i Komisionit për mosvlerësimin si të ardhura të ligjshme të vlerës totale të pagave të përfituara nga punësimi në këto shoqëri tregtare dhe të paguara prej tyre nëpërmjet sistemit bankar, me justifikimin se për këto pagesa nuk janë përmbushur detyrimet tatimore nga ana e punëdhënësve është i pabazuar në ligj. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk gjenden në kushtet e deklarimit të pasaktë të të ardhurave të përfituara nga bashkëshorti, z. F. Sh., si më sipër shpjeguar dhe se këto të ardhura nuk cenojnë standardin e të ardhurave të ligjshme, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës”.

12.10 Gjithashtu, në seancën dëgjimore, pyetjes së drejtuar nga trupi gjykues nëse mosdeklarimi i pagës nga bashkëshortit si i punësuar ka të bëjë me faktin që nëse ai do të deklaronte pagën, mund të humbiste pensionin e parakohshëm të ushtarakut, subjekti iu përgjigj se nuk ka dijeni për këtë, por nuk e shikon mosdeklarimin e pagës si option për këtë qëllim. Subjekti iu përgjigj edhe pyetjes në lidhje me aneksin e kontratës datë 5.2.2005, duke shpjeguar se ky aneks nuk është hartuar para noterit, por e ka pasur vetë punëdhënësi. Pra, në shpjegimet e saj në seancë dëgjimore, subjekti i qëndron sërish faktit se në vitin 2005 ka ekzistuar marrëdhënia e punës së bashkëshortit të saj.

12.11 Në përfundim të prapësimeve të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar që duke u bazuar në faktet e paraqitura, në argumentet e dhëna më lart dhe në analizën e ligjshmërisë së të ardhurave të realizuara nga marrëdhënia e punësimit të bashkëshortit E. B. pranë autoshkollës “****” sh.p.k., Komisioni të përfshijë në analizën financiare të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti në periudhën 2005 – mars 2011, duke i vlerësuar ato të ligjshme, pasi këto të ardhura janë deklaruar rregullisht dhe në çdo vit përkatës, referuar DIPP-ve të viteve 2005 – 2011, veprim ky i cili do të ishte në përputhje me kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe me vendimmarrjet e Kolegjit e të Komisionit.

Vlerësimi i Komisionit

12.12 Në bazë të të gjitha dokumenteve të administruara dhe prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni konkludon se:

i) Subjekti ka deklaruar çdo vit në DIPP, në mënyrë të rregullt dhe të vazhdueshme, të ardhurat e bashkëshortit si instruktor në autoshkollën “****” sh.p.k.; shuma e këtyre të ardhurave përputhet plotësisht me informacionin e dhënë nga kjo shoqëri⁹⁴.

ii) Subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet dokumenteve të depozituara⁹⁵, ka provuar ekzistencën e marrëdhënies së gjatë e të vazhdueshme të punës midis punëdhënësit “****” sh.p.k.⁹⁶ dhe punëmarrësit, bashkëshortit të saj, i cili në periudhën janar 2005 – dhjetor 2016 ka punuar si instruktor autoshkolle me automjetin e tij, duke e vënë në dispozicion të punëdhënësit.

iii) Vërtetimi i marrëdhënies së punësimit passjell pagesën e punëmarrësit pasi çdo marrëdhënie pune gjeneron të ardhura dhe, konkretisht, pagën e përcaktuar në kontratë 30,000 lekë/muaj, ndonëse nuk është përcaktuar nëse është neto apo bruto, plus pagesën 30,000 lekë/muaj për përdorimin e automjetit sipas aneksit të kontratës datë 5.2.2005, i cili ka qenë në fuqi deri në datën 18.6.2007, kur palët kontraktore kanë lidhur kontratë huapërdorjeje të automjetit, pa shpërblim.

iv) Legjislacioni për pagesën e tatimit në burim mbi të ardhurat nga punësimi, si dhe ai për pagesën e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, detyron punëdhënësin të llogarisë, të mbajë dhe të derdhë në organet tatimore qoftë tatimin mbi të ardhurat, qoftë sigurimet shoqërore e shëndetësore. Vetëm me ligjin nr. 10343, datë 28.10.2010⁹⁷ “Për ndryshimin e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” u përcaktua detyrimi i të punësuarve që të plotësonin deklaratën individuale vjetore të të ardhurave, duke deklaruar kështu të ardhurat vjetore mbi 200,000 lekë/vit. Për më tepër, edhe në Kodin e Punës përcaktohet detyrimi ekskluziv i punëdhënësit për kryerjen e këtyre pagesave.

12.13 Qëndrimi i mbajtur nga Kolegji dhe që e ka sjellë në vëmendje subjekti i rivlerësimit në parashtrimet e saj, në lidhje me mospenalizimin e subjektit në rastet kur përgjegjësia ligjore për pagesën e tatimit mbi të ardhurat nuk ka qenë e subjektit të rivlerësimit apo personit të lidhur me të, por e palëve të treta, nuk ka të bëjë me situata të ngjashme me subjektin e rivlerësimit Anila Bebeçi.

⁹⁴ Shihni vërtetimin e datës 20.1.2017 nga shoqëria “****” sh.p.k., në aneksin ***, faqe ***, në dosjen e administruar nga ILDKPKI-ja.

⁹⁵ (i) Kontratë punësimi (noteriale) datë 10.1.2005, e lidhur midis punëdhënësit, shoqëria “****” sh.p.k., dhe punëmarrësit E. B., me detyrë instruktor autoshkolle me automjetin e tij me targë ***, për 5 vjet, me pagë 30,000 lekë/muaj; (ii) aneks kontrate datë 5.2.2005, i kontratës së punës datë 10.1.2005, ku punëdhënësi, shoqëria tregtare “****” sh.p.k. dhe punëmarrësi E. B. dakordësohen të paguhet punëmarrësi edhe në shumën 30,000 lekë për përdorimin e automjetit të tij (shihni shkresën nr. *** prot., datë 23.6.2023, e DPSHTRR-së); (iii) kërkesë datë 5.1.2005, e shtetasit E. B., si pronari i automjetit me targë ***, drejtuar DPSHTRR-së për ndryshimin e konstruksionit të automjetit, duke e përshtatur atë si autoshkollë dhe shkresa nr. *** prot., datë 10.1.2005, nga DPSHTRR-ja, për miratimin e kësaj kërkesë (shihni shkresën nr. *** prot., datë 23.6.2023, të DPSHTRR-së, drejtuar Komisionit); (iv) kontratë noteriale huapërdorjeje datë 18.6.2007 (shihni shkresën nr. *** prot., datë 23.6.2023, të DPSHTRR-së) midis huamarrësit, autoshkolla “****” sh.p.k., dhe huadhënësit E. B., ku ky i fundit automjetin e tij me targë *** ia jep huamarrësit në përdorim pa kundërshpërblim për qëllime të guidës me kursantë për 3 vjet dhe me kushtin që huamarrësi të mos e japë automjetin me nënhuadhënie, duke nënkuptuar që automjeti do të përdoret vetëm nga huadhënësi si i punësuar pranë huamarrësit (ndërkohë që kontrata e punës datë 10.1.2005 ishte ende në fuqi) deri në datën 18.6.2010; (v) bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka punuar pranë punëdhënësit me mjetin e tij si shofer autoshkolle deri në vitin 2014 (shihni shkresën nr. *** prot., datë 23.6.2023, të DPSHTRR-së) e pas kësaj ia ka shitur punëdhënësit sipas kontratës noteriale të shitjes datë 10.1.2015, në përmbushje të detyrimit ligjor të autoshkollave (sipas udhëzimit nr. ***, datë 25.3.2003, të DPSHTRR-së, deri në vitin 2014 autoshkollat mund të merrnin automjetet në përdorim ose në pronësi dhe pas këtij viti vetëm në pronësi); (vi) vërtetimi nga DRSSH Durrës, që konfirmon pagat bruto e neto mbi të cilat shoqëria “****” dhe autoshkolla “****” sh.p.k. ka paguar sigurimet shoqërore e shëndetësore që nga muaji mars 2011 – 2014 për punëmarrësin E. B., ndërsa pas muajit maj 2015 deri në dhjetor 2020 janë paguar nga punëdhënësi, personi fizik “M. C.” (shihni shkresën nr. *** prot., datë 4.7.2023, të DRSSH-së Durrës); (vii) vërtetimi nga DPT-ja, që konfirmon se shoqëria “****” dhe autoshkolla “****” sh.p.k. ka derdhur tatimin mbi të ardhurat personale për punëmarrësin E. B. që nga muaji dhjetor 2011 – maj 2015, ndërsa pas muajit maj 2015 – dhjetor 2020 janë paguar nga punëdhënësi, personi fizik “M. C.” (shihni shkresën nr. *** prot., datë 4.7.2023, të DRSSH-së Durrës). Në lidhje me këtë fakt, Komisioni sjell në vëmendje se DPT-ja ka të dhëna në sistem nga muaji dhjetor 2011 e në vijim.

⁹⁶ Pas vitit 2010, me shoqërinë “****” dhe autoshkolla “****” sh.p.k., që ka përthithur shoqërinë “****” sh.p.k. dhe nga janari 2005 e më pas me personin fizik “M. C.”, me aktivitet “Autoshkollë” (ish-ortak në shoqëritë e mëparshme punëdhënëse).

⁹⁷ Ky ligj ka hyrë në fuqi më 1.1.2011.

Vetëm vendimi nr. 35, datë 22.9.2022, i Kolegjit është më i përafërt me situatën në llojin e të ardhurave të gjeneruara nga subjekti i rivlerësimit, por përsëri subjekti nuk ndodhet në të njëjtat kushte dhe nuk ka sjellë prova të ngjashme me ato që ka paraqitur, i cili vlerësohet në këtë vendim të Kolegjit⁹⁸.

12.14 Nga të gjitha sa më sipër, në përfundim të procesit Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit:

- ka arritur të provojë bindshëm marrëdhënien e punësimit dhe ekzistencën e të ardhurave në kohën e krijimit të tyre;
- ka arritur të provojë me dokumentacion përfitimin e një pjese të konsiderueshme të tyre;
- nuk ka provuar pagesën e tatimit në burim për këto të ardhura, pavarësisht nëse përgjegjësia është e tij apo e punëdhënësit.

12.15 Për sa më lart, Komisioni, duke u bazuar në bindjen e tij të brendshme se të ardhurat janë krijuar nga punësimi i deklaruar ndër vite dhe i vërtetuar me dokumentacion ligjor dhe jo nga korrupsioni, si dhe këto të ardhura janë përdorur për shpenzime jetike, të cilat rezultojnë të jenë modeste e jo për krijimin e pasurive, parë edhe nën dritën e praktikës ligjore sipas vendimeve të Kolegjit, siç u përmendën më lart, vlerësoi të marrë në konsideratë si të ardhura të ligjshme e të përfshijë në analizën financiare të ardhurat përkatëse sipas viteve, bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, dhe në Udhëzimin nr. 5, datë 30.1.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, të kohës, konkretisht:

- Për vitin 2005, të konsiderojë përfitimin e shumës 30,000 lekë/muaj si shpërblim për përdorimin e automjetit të tij, duke arsyetuar se pavarësisht se kjo shumë nuk konsiderohet si një e ardhur në kuptim të ligjit nr. 8437/1998, ajo është një formë shkëmbimi për konsumin që i ndodh automjetit, e destinuar për të përballuar amortizimin e tij dhe, si e tillë, nuk është e tatueshme. Për më tepër, kjo shumë është e disponueshme për t’u përfshirë dhe përdorur në buxhetin familjar të subjektit. Sa i takon pagës së vendosur në kontratë prej 30,000 lekë/muaj, ajo nuk mund të konsiderohet si e ardhur e ligjshme, pasi për të nuk është provuar pagesa e tatimit në masën e përcaktuar nga ligji i kohës⁹⁹. Në total, shuma 360,000 lekë.
- Për vitin 2006 është vepruar njësoj si për vitin 2005, pasi paga minimale mbi të cilën paguhet tatim mbetet e njëjtë. Në total, shuma 360,000 lekë.
- Për vitin 2007 të konsiderojë përfitimin e shumës 30,000 lekë/muaj për periudhën janar – qershor 2007¹⁰⁰, si shpërblim për përdorimin e automjetit të tij dhe shumën 10,000 lekë/muaj nga paga e përfituar, pasi për shumën 0 – 10,000 lekë/muaj nuk paguhet tatim. Në total, shuma vjetore 300,000 lekë.

⁹⁸ Sipas këtij vendimi personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit ka plotësuar disa kushte: (i) konfirmimin e marrëdhënies së punësimit nga organi tatimor; (ii) kalimin e pagës në bankë; (iii) vlerat e derdhura në bankë përputhen me vlerat e deklaruara në vërtetimet e punëdhënësve, si dhe me vlerat e deklaruara nga subjekti në deklaratimet periodike dhe atë të pasurisë *Vetting*; (iv) mospërmbushja e detyrimeve të palës punëdhënëse nuk ka qenë e ditur dhe, rrjedhimisht, e pranuar nga punëmarrësi; (v) personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit nuk ka qenë në keqbesim në raport me sjelljen e palës punëdhënëse.

⁹⁹ Në vitin 2005, tatimi mbi të ardhurat është në masën 1% për të ardhura mbi 0 deri 14,000 lekë dhe 5% për të ardhurat 14,000 lekë deri 40,000 lekë.

¹⁰⁰ Pas kësaj periudhe hyn në fuqi kontrata noteriale e huapërdorjes datë 18.6.2007 pa kundërshtpërblim.

- Për vitin 2008, shuma 10,000 lekë/muaj nga paga e përfituar, pasi për shumën 0 – 10,000 lekë/muaj nuk paguhet tatim; këtë vit shtetasi E. B. nuk ka përfituar asnjë shpërblim për përdorimin e automjetit të tij. Në total, shuma 120,000 lekë.
- Për vitin 2009, shuma 10,000 lekë/muaj nga paga e përfituar, pasi për shumën 0 – 10,000 lekë/muaj nuk paguhet tatim. Në total, shuma 120,000 lekë.
- Për vitin 2010 nuk ka kontratë punësimi dhe as kalime në bankë. Palët kanë vetëm kontratën e huapërdorjes së automjetit datë 18.6.2007, pa kundërshtëpërblim e, për këtë arsye, për vitin 2010 nuk janë konsideruar të ardhura nga puna e bashkëshortit të subjektit në autoshkollën “****” sh.p.k.
- Në periudhën mars 2011 – dhjetor 2016, të ardhurat janë konsideruar të ligjshme që me rezultatet e hetimit, pasi paga e z. E. B. kalon në Alpha Bank. Për këtë marrëdhënie pune janë provuar pagesat e sigurimeve shoqërore, madje nga dhjetori 2011 kemi edhe informacion mbi pagesat e TAP-it¹⁰¹.

13. Analiza financiare për të gjithë periudhën e rivlerësimit

13.1 Në analizën financiare, dërguar subjektit të rivlerësimit me rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni ka marrë në konsideratë:

- shumën *cash* 800,000 lekë, krijuar deri në fund të vitit 2006, e cila nuk ishte e përfshirë si burim për blerjen e apartamentit, pasi dukej se subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar e detyruar për të justifikuar plotësimin e çmimit për blerjen e apartamentit;
- shumën 1 milion lekë, që bashkëshorti i subjektit ka marrë dhuratë nga babai në vitin 2011, e cila ishte përfshirë si e ardhur e ligjshme;
- dy huat që subjekti i rivlerësimit ka marrë nga motra dhe kunati i saj, të cilat ishin përfshirë si burime të ligjshme;
- gjendjen e likuiditeteve të deklaruara si “Kursime nga paga” ndër vite, e cila ishte bazuar në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit ndër vite dhe shpjegimet e saj gjatë hetimit administrativ;
- pagat e bashkëshortit si inspektor në autoshkollë, të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit për periudhën 2005 – 2011, të cilat nuk ishin përfshirë si të ardhura të ligjshme.

13.2 Sipas kësaj analize, pamundësia totale e subjektit të rivlerësimit (shuma e viteve me balanca negative) duket se ishte -2,933,364 lekë. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i ngarkoi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e këtij konkluzioni.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit për barrën e provës dhe vlerësimi i Komisionit

13.3 Në lidhje me mospërfshirjen në analizë financiare të shumës *cash* 800,000 lekë si burim për blerjen e apartamentit me sip. 108.8 m², subjekti i rivlerësimit ka paraqitur prapësimet e tij në lidhje me barrën e provës dhe Komisioni i ka pranuar njohjen e shumës 800,000 lekë si burim i ligjshëm i krijuar gjatë viteve 2004 – 2006 dhe i përdorur për blerjen e apartamentit me sip. 108.8 m² në vitin 2007 (sikurse trajtuar në pikat 1.39 dhe 11.5 të këtij vendimi).

¹⁰¹ Pagesat e detyrimeve (sigurime shoqërore, shëndetësore dhe TAP) janë të administruara nga Zyrat Rajonale të Tatimeve, në formë elektronike, nga dhjetori i vitit 2011 e në vijim.

13.4 Në lidhje me njohjen si të ardhura të ligjshme të pagave të bashkëshortit si instruktor pranë shoqërisë “***” sh.p.k. gjatë viteve 2005 – 2011, sikurse deklaruar nga subjekti në DIPP-të e këtyre viteve, Komisioni ka marrë në konsideratë pjesërisht pretendimet e subjektit (sikurse trajtuar në pikat 12.9 - 12.15 të këtij vendimi).

13.5 Pasi Komisioni ka marrë në konsideratë dy elementet e mësipërme pas prapësimeve të barrës së provës nga subjekti i rivlerësimit, pamundësia totale e subjektit (shuma e viteve me balanca negative) ndryshoi nga -2,933,364 lekë në -1,593,364 lekë.

13.6 Në përfundim, Komisioni, duke iu referuar bindjes së tij të brendshme se: (i) pasuritë e vlerësuara në këtë proces nuk janë krijuar nga korrupsioni, por nga të ardhurat nga puna, të vërtetuara me dokumentacion ligjor e të deklaruar periodikisht në mënyrë të rregullt; (ii) duke vlerësuar faktet dhe rrethanat në tërësi mbi mënyrën e krijimit të këtyre pasurive që janë proporcionale me të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe familjes së saj; (iii) shpenzimet modeste të kryera nga subjekti dhe familja e saj, marrë në konsideratë edhe faktin se kemi të bëjmë me një subjekt rivlerësimi me një karrierë thajse 30-vjeçare në sistemin e drejtësisë – vlerëson se bazuar edhe në parimet e objektivitetit dhe proporcionalitetit balanca negative në shumën -1,593,364 lekë nuk arrin deri në atë nivel saqë të përbëjë shkak për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Anila Bebeçi.

B. KONTROLLI I FIGURËS

1. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka dërguar¹⁰² pranë Komisionit raportin nr. ***, datë 2.11.2017, mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Anila Bebeçi, të deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 20.9.2023, të KDZH-së. Sipas këtij raporti, Grupi i Punës së AKSIK-së, në përfundim të verifikimit ka konkluduar se:

a) Subjekti i rivlerësimit ka pasur të njëjtat gjeneralitete si ato që ka deklaruar vetë në deklaratën për kontrollin e figurës.

b) Për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimin të organizuar.

Sa më sipër, Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.

2. Nga hetimi i kryer nga ana e tij, Komisioni nuk ngriti dyshime për sa i përket përshtatshmërisë së subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës në lidhje me kriterin e figurës.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

1. Grupi i Punës në KLP, në bazë të ligjit nr. 84/2016 dhe ligjit nr. 96/2016, ka hartuar raportin¹⁰³ mbi aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit Anila Bebeçi, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, të miratuar me vendimin nr. ***, datë 19.9.2023.

2. Ky raport, për periudhën 8.10.2013 – 8.10.2016 është hartuar duke u bazuar në përshkrimin dhe analizimin e tri grupeve të burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti; (ii) 5 dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; (iii) të dhënave nga 23 prokuroritë e rretheve gjyqësore, sektori i protokoll-arkivit, si dhe burimet arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme. Ky raport i ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit: (i) aftësitë profesionale; (ii) aftësitë organizative; (iii) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; (iv) aftësitë personale dhe angazhimi profesional, për të cilat Grupi i Punës ka konkluduar me një vlerësim pozitiv për subjektin e rivlerësimit¹⁰⁴.

¹⁰² Me shkresat nr. *** prot., datë 25.9.2023 dhe nr. *** prot., datë 31.10.2017, të AKSIK-së.

¹⁰³ Raporti nr. *** prot., datë 27.4.2023, i KLP-së.

¹⁰⁴ 5/(i) **Aftësitë profesionale**, ku përfshihen: (a) njohuritë ligjore; (b) arsyetimi ligjor. Në lidhje me njohuritë ligjore, në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se subjekti i rivlerësimit identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe arsyeton qartë mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret; shfaq aftësi në interpretimin e ligjit, analizën e jurisprudencës dhe arsyetimit ligjor e logjik, duke marrë vendime e duke përpiluar akte të qarta e të plota. Në lidhje me arsyetimin ligjor, subjekti i rivlerësimit shfaq aftësi në pasqyrimin e rrethanave të faktit, analizën e provave në përputhje me bazën ligjore të aplikueshme. Aktet përpilohen qartë dhe të kuptueshme. Respektohen përgjithësisht rregullat e drejtshkrimit dhe niveli i arsyetimit është në përputhje me standardin e procesit të rregullt ligjor.

5/(ii) **Aftësitë organizative**, ku përfshihen: (a) aftësia për të përballuar ngarkesën në punë; (b) aftësia për të kryer procedurat gjyqësore; (c) aftësia për të administruar dosjet. Në lidhje me aftësinë për të përballuar ngarkesën në punë – referuar vërtetimit nr. ***, datë 16.10.2020 dhe listës së statistikave të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka trajtuar 412 çështje, përfshirë edhe ato të pezulluara. Konstatohet se prokurorja Anila Bebeçi është përballur me një ngarkesë të konsiderueshme pune, duke treguar eficiencë në marrjen e vendimeve brenda një afati të arsyeshëm, referuar natyrës dhe shumëllojshmërisë së veprimeve hetimore. Në 5 dosjet e përzgjedhura me short, kohëzgjatja e trajtimit të tyre nga subjekti i

3. Raporti, gjithashtu, është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e informacioneve në vijim të vendimit.

C/1. Formulari i vetëdeklarimit dhe dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

4. Formulari i vetëdeklarimit, dorëzuar më 21.1.2017, paraqitet i nënshkruar i plotë, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, duke bashkëlidhur dokumentacionin e nevojshëm¹⁰⁵.

5. Sipas deklarimit në formularin e vetëdeklarimit rezulton se znj. Anila Bebeçi, në periudhën 16.2.1994 e në vazhdim ushtron detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

6. Në formularin e vetëdeklarimit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se në funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka trajtuar 338 çështje penale dhe 206 materiale kallëzuese. Gjithashtu, ka marrë pjesë në 8 trajnime.

7. Sipas të dhënave nga Prokuroria e Përgjithshme, subjekti Anila Bebeçi është vlerësuar nga Prokurori i Përgjithshëm si vijon:

- Për vitet 2013 dhe 2014 është vlerësuar “mirë” dhe për vitet 2015 dhe 2016 është vlerësuar “shumë mirë”.

C/2. Tri dokumentet ligjore të përzgjedhura për vlerësim nga subjekti i rivlerësimit

8. Bashkëlidhur formularit të vetëdeklarimit, subjekti i rivlerësimit ka depozituar tri dokumente ligjore të përpiluara e nënshkruara prej saj në cilësinë e prokurorit të çështjes.

9. Në aktet nr. 1 e 2, si më poshtë, të llojit “Konkluzione përfundimtare”, vërehet se në përfundim të hetimit, ku ka rezultuar e provuar kryerja e veprës penale, bazuar në nenin 378 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur para Gjykatës kërkimet e saj mbi fajësinë e të pandehurit, llojin dhe masën e dënimit, si dhe qëndrimin mbi provat materiale, referuar nenit 190 të këtij Kodi.

rivlerësimit varion nga 6 ditë deri në 6 muaj e 10 ditë. Në lidhje me *aftësinë për të kryer procedurat hetimore*, subjekti në rastin e vendimmarrjes mbi mosfillimet e procedimit penal rezulton të ketë argumentuar mungesën e elementeve të veprës penale. Në procedimet penale, për të cilat është vendosur pushimi i hetimeve, ka drejtuar hetimet e kryera nga policia gjyqësore, duke argumentuar vendimmarrjen për pushimin e procedimit penal apo për të mbështetur akuzën në çështjen me të pandehur të dërguar për gjykim. Në lidhje me *aftësinë për të administruar dosjet*, konstatohet se subjekti, në ushtrim të kompetencave të saj, ka aftësi për të administruar dosjet.

5/(iii) **Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale**, ku përfshihen: (a) *etika në punë*; (b) *integriteti*; (c) *paanësia*. Në lidhje me *etikën në punë*, nuk rezulton të ketë pasur ankesa për qëndrime jo në përputhje me etikën profesionale të prokurorit. Në lidhje me *integritetin*, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm. Në lidhje me *paanësinë*, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit; nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak anësie të dokumentuar; asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave, si dhe nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.

5/(iv) **Aftësitë personale dhe angazhimi profesional**, ku përfshihen: (a) *aftësitë e komunikimit*; (b) *aftësia për të bashkëpunuar*; (c) *gatishmëria për t'u angazhuar*. Në lidhje me *aftësinë e komunikimit*, nuk rezultojnë të dhëna që flasin për mënyrën e komunikimit ndërpersonal të subjektit me pjesëmarrësit në proces. Në lidhje me *aftësinë për të bashkëpunuar*, nuk rezultojnë të dhëna konkrete që flasin mbi aftësinë e subjektit për të bashkëpunuar mes kolegësh apo më gjerë. Në lidhje me *gatishmërinë për t'u angazhuar*, subjekti ka marrë pjesë në 8 trajnime, nga të cilat një i zhvilluar në Budapest, Hungari.

¹⁰⁵ Dokumente ligjore “Konkluzione në ngarkim të të pandehurit E. B.” dhe “Vendim për mosfillimin e procedimit penal” mbi kallëzimin penal nr. ***/2016; vlerësimi profesional i punës për vitet 2012, 2013, 2014 e 2016; certifikata trajnimesh; vërtetim nr. ***, datë 26.10.2016, i Shkollës së Magjistraturës.

10. Të tria dokumentet më poshtë janë strukturuar, duke i ndarë në pjesën hyrëse (parashtrohen gjeneralitetet e të pandehurit dhe akuza në ngarkim të tij), pjesën përshkruese-arsyetuese (përshkruhen rrethanat e faktit, provat e administruara gjatë gjykimit, analiza ligjore), pjesën konkluduese (pasqyrohen kërkimet përfundimtare). Në arsyetimin e konkluzioneve përfundimtare referohen normat e Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, duke respektuar standardet e një akti ligjor të kësaj natyre. Dokumenti ligjor është i strukturuar e me gjuhë të kuptueshme dhe respektohen përgjithësisht rregullat drejtshkrimore.

- **Nuk u konstatuan mangësi në këto tri dokumente.**

10.1 Dokumenti nr. 1 – Konkluzione përfundimtare në ngarkim të të pandehurit A. S., akuzuar për veprat penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive” (nenet 278/2, 278/3 e 280 të Kodit Penal)

Nga shqyrtimi i aktit ligjor ka rezultuar se në datën 1.8.2015 policia gjyqësore ka sekuestruar në banesën e të pandehurit A. S., në fshatin ***, Durrës, një armë zjarri automatike të tipit “Kallashnikov”, 90 copë fishekë, si dhe një armë gjahu teke. I pandehuri nuk kishte leje për mbajtjen e armëve të zjarrit dhe atyre sportive.

10.2 Dokumenti nr. 2 – Konkluzione përfundimtare në ngarkim të të pandehurit E. B., akuzuar për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” (neni 283/1 i Kodit Penal)

Nga shqyrtimi i aktit ligjor ka rezultuar se në datën 19.7.2015 punonjësit e Policisë së Shtetit kanë konstatuar se i pandehuri E. B. kishte me vete një qese plastmase, brenda së cilës ishin 22 qese farmaceutike të mbushura me lëndë bimore të ngjashme me *cannabis sativa*, me peshë 11 gramë, përfshirë ambalazhin.

10.3 Dokumenti nr. 3 – Vendim për mosfillim të procedimit penal mbi aktet e kallëzimit nr. ***/2016

Nga shqyrtimi i akteve ka rezultuar se në datën 10.10.2016 shtetasi P. Gj. ka kallëzuar faktin e punimeve të gërmimit në kundërshtim me ligjin nga punonjësit e Bashkisë ***, në një truall që pretendohej në pronësi të kallëzuesit dhe që i kishte sjellë dëmtrim fizik tokës truall.

Nga hetimi, subjekti i rivlerësimit ka konkluduar se kallëzuesi nuk ishte pronar i truallit dhe Bashkia *** po kryente punime për interes publik, sipas lejes së ndërtimit të miratuar me vendimin nr. ***, datë 13.9.2016. Ndërkohë, pronarët e truallit që kishin aplikuar në ZVRPP, nuk ishin pajisur me akt pronësie dhe, për shkak të mangësive të dokumentacionit ligjor, nuk ishin përfshirë në procedurë shpronësimi. Subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se në momentin që pronarët e truallit do të regjistronin pronën në ZVRPP-në Durrës, kishin të drejtë që me padi civile për pushim të cenimit të pronësisë t’i drejtoheshin Gjykatës Civile. Duke vlerësuar se nuk kishte elemente të ndonjë vepre penale dhe se kishte shkaqe ligjore që pengonin regjistrimin e procedimit penal, bazuar në nenin 290/1, shkronja “ç” dhe nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti i rivlerësimit ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, duke njoftuar personat e interesuar.

C/3. 5 dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim

11. Dosja nr. 1 – Kallëzimi penal nr. ***/2014 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendim mosfillimi, datë 10.12.2014

11.1 Ka rezultuar se në datën 26.11.2014, kushërinjtë A. L. dhe F. L., rreth orës 20:00, gjatë rrugës për në shtëpi, janë takuar me shtetasit M. dhe K. B.. Për shkak të debatit të zhvilluar mes tyre, shtetasi M. B. e ka goditur me thikë në kofshën e majtë shtetasin A. L., të cilin e ka dërguar në spital kushëriri i tij, F. L..

11.2 Sipas aktekspertimit nr. ***, datë 1.12.2014, tek i dëmtuari A. L. janë konstatuar dëmtime, që kategorizoheshin në humbje të aftësisë së përkohshme në punë, në masën deri në 9 ditë dhe, kështu, subjekti i rivlerësimit ka konkluduar se fakti i referuar përmbante elementet e veprës penale “Dëmtime të tjera me dashje” (neni 90 i Kodit Penal).

11.3 Në datën 1.12.2014, i dëmtuari A. L. ka deklaruar para oficerëve të policisë gjyqësore se kërkonte që shtetasi M. B. të mos ndiqej penalisht. Referuar nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale “I dëmtuari akuzues”, që përcakton procedurën e ndjekjes penale me ankimin e drejtpërdrejtë në Gjykatë për disa vepra penale, ku përfshihet edhe vepra penale e parashikuar nga neni 90 i Kodit Penal, subjekti i rivlerësimit ka konkluduar se kishte shkaqe ligjore që pengonin regjistrimin e procedimit penal. Bazuar në nenet 59/1, 290/1, shkronja “ç” dhe 291 të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, duke njoftuar personat e interesuar¹⁰⁶.

11.4 Konstatohet se nga ana e subjektit të rivlerësimit në cilësinë e prokurores së çështjes nuk janë kryer veprime hetimore (në përputhje me nenin 24 të Kodit të Procedurës Penale) në lidhje me përdorimin e thikës nga shtetasi M. B., duke hetuar në këtë rast, përveç veprës penale “Dëmtime të tjera me dashje”, edhe për veprën penale “Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta”, e parashikuar nga neni 279 i Kodit Penal, vepër që parashikon dënim me gjobë ose me burgim.

11.5 Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit që të japë shpjegime për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me barrën e provës

11.6 Në prapësime, subjekti ka shpjeguar se: (i) me urdhrin datë 4.12.2014 nga drejtuesi i Prokurorisë ka cituar se rezulton që nuk duhet regjistruar procedimi penal; (ii) materiali është referuar nga Komisariati i Policisë Durrës në datën 3.12.2014 për një ngjarje të ndodhur në datën 26.11.2014, pra ngjarja kishte ndodhur një javë më parë; (iii) që me dërgimin e materialeve të para hetimore është administruar edhe akti i ekspertimit mjekoligjor nr. ***, i cili përcakton se dëmtimet e shtetasit A. L. kanë shkaktuar humbjen e aftësisë për punë në masën deri 9 ditë dhe nga oficeri i policisë gjyqësore është marrë procesverbali i heqjes dorë nga e drejta e ankimit; (iv) nga materialet e dosjes rezulton se njoftimi nga policia është marrë në spitalin Durrës, ku i dëmtuari ka shkuar të mjekohet dhe fillimisht ai ka deklaruar se është goditur me thikë dy herë në kofshën e majtë, ndërsa në procesverbalin e heqjes dorë ka deklaruar se ka qenë i dehur dhe nuk i kujtohet me çfarë e kanë goditur, por ka parë se në kofshën e majtë i dilte gjak, ndaj dhe ka shkuar në spital. Nga ana tjetër, shtetasi M. B. nuk pranon ta ketë goditur me thikë.

11.7 Gjatë kryerjes së veprimeve hetimore nuk është sekuestruar në cilësinë e provës materiale ndonjë send i kundërligjshëm dhe as nga procesverbali i këqyrjes së vendit të ngjarjes nuk rezulton të jetë gjetur apo fiksuar ndonjë send i kundërligjshëm, aq më tepër thikë. Në këtë

¹⁰⁶ Për detaje shihni fashikullin penal në dosjen e aftësive profesionale.

mënyrë nuk kishte si të hetohej për një send hipotetik. Nga veprimet e kryera dhe tërësia e akteve të administruara nuk rezultojnë elementet e ndonjë vepre penale tjetër dhe as asaj të parashikuar nga neni 279 i Kodit Penal, pasi mungojnë elementet bazike të kësaj vepre penale. Nga akti i ekspertimit rezulton se dëmtimet janë shkaktuar nga një mjet i fortë prerës. Mjeti prerës mund të jetë një thikë, një bisturi ose send tjetër, që ka presë dhe majë të mprehtë dhe shkakton plagë të tilla. Përfundimisht, nga ana e subjektit të rivlerësimit, mbi 1 javë nga dita e ndodhjes së ngjarjes, nuk mund të kryheshin hetime në lidhje me një send të kundërligjshëm, ku jo vetëm ky send mungonte, por edhe nëse do të ishte sekuestruar në cilësinë e provës materiale, duhet t'i nënshtrohej ekspertimit teknik, nëse plotësonte kushtet teknike për t'u klasifikuar si armë e ftohtë në kuptim të nenit 279 të Kodit Penal.

11.8 Bashkëlidhur prapësimeve, subjekti i rivlerësimit ka depozituar shkresën nr. *** prot., datë 17.10.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, që konfirmon se shtetasit A. L. e M. B. nuk kanë ushtruar ankim pranë kësaj Gjykate ndaj vendimit të prokurorit mbi kallëzimin penal nr. ***/2014.

Vlerësimi i Komisionit

11.9 Komisioni, pasi shqyrtoi dosjen hetimore, konstaton dhe vlerëson ndër të tjera: (i) urdhri datë 4.12.2014 nga drejtuesi i Prokurorisë, që ka cituar se: *“Rezulton që nuk duhet regjistruar procedimi penal...”*; (ii) procesverbali datë 26.11.2014 *“Për këqyrjen dhe marrjen e provave materiale”*, ku nuk përmendet të jetë marrë si provë arma thikë; (iii) procesverbali datë 26.11.2014 *“Për këqyrjen e vendit të ngjarjes”*, i shoqëruar me foto të vendngjarjes, ku nuk evidentohet asnjë armë e ftohtë; (iv) procesverbali datë 1.12.2014 *“Për heqjen dorë nga ankimi”*, ku kallëzuesi ka cituar se gjatë debatit ka qenë i dehur dhe nuk i kujtohet me çfarë e kanë goditur; (v) procesverbali datë 1.12.2014 para policisë për pyetjen e shtetasit M. B., i cili mohon ta ketë qëlluar A. me thikë; (iv) procesverbalet datë 26.11.2014 për pyetjen e dëshmitarëve etj.

11.10 Për sa më lart, qëndrojnë rrethanat që citon subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e saj dhe ajo nuk mund të penalizohet për moskryerjen e hetimeve për veprën penale *“Armëmbajtje e ftohtë”*.

- Komisioni arriti në përfundimin se nuk ka problematika në këtë dosje.

12. Dosja nr. 2 – Kallëzimi penal nr. ***/2015 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendim mosfillimi datë 17.6.2015

12.1 Nga shqyrtimi i akteve ka rezultuar se në datën 28.5.2015 shtetasi E. S. ka depozituar kallëzim penal në Komisariatin e Policisë Durrës për faktin e humbjes së telefonit celular, modeli *“Iphone 4”*. Kallëzuesi ka shpjeguar se kishte shkuar për të kryer disa procedura doganore. Pasi i ka kryer këto në agjencinë doganore *“****”* në Portin e Durrësit, është rikthyer tek automjeti i tij dhe ka konstatuar se i mungonte telefoni. Ka kontrolluar në automjet, si dhe tek pika ku priteshin biletat për të hyrë në ambientet e portit, por nuk e ka gjetur atë. Nga ana tjetër, shtetasja B. K., me detyrë inspektore e dhënies së lejeve ditore në Portin e Durrësit, ka shpjeguar se mbante mend që një shtetas kishte marrë leje ditore dhe gjatë gjithë kohës ka qenë duke folur në telefon e, më pas, ky shtetas ishte kthyer dhe e kishte pyetur nëse e kishte harruar aty telefonin, pasi e kishte humbur.

12.2 Duke analizuar në tërësi të dhënat e administruara, subjekti i rivlerësimit ka konkluduar se fakti i referuar nuk përmbante elementet e figurës së veprës penale “Vjedhja” (neni 134 i Kodit Penal), pasi nuk rezultonte asnjë dyshim i arsyeshem që telefoni i kallëzuesit të ishte marrë si rezultat i veprimeve të kundërligjshme, me qëllim përfitimi material. Në këto rrethana, kishte shkaqe ligjore që pengonin regjistrimin e procedimit penal dhe, bazuar në nenin 290/1, shkronja “ç” dhe nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, duke njoftuar personat e interesuar¹⁰⁷.

12.3 Konstatohet se përveç pyetjes së kallëzuesit dhe personit që dyshohej nga kallëzuesi se mund të kishte marrë telefonin, subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer asnjë veprim tjetër hetimor (si p.sh. të merreshin të dhëna nga shoqëritë celulare), veprime që do të ndihmonin në arritjen e një konkluzioni sa më objektiv. Subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprime të plota hetimore në përputhje me nenin 24 të Kodit të Procedurës Penale.

12.4 Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me barrën e provës

12.5 Në prapësime, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: (i) në formularin për trajtimin e materialit kallëzues, datë 2.6.2015, është cilësuar se nuk duhet të procedohet me regjistrimin e procedimit penal; (ii) vetë kallëzuesi ka deklaruar se telefonin celular mund ta ketë harruar tek një agjenci, ku ka hyrë për të parë një biletë për në Portin detar Durrës. Më pas ka deklaruar rrugën që ka përshtuar për tek një agjenci doganore, ku, pasi ka mbaruar punë duke vulosur disa dokumente dhe ka shkuar tek makina, ka konstatuar se i mungonte telefoni celular. Më pas ka shkuar tek vendet ku dyshonte se kishte lënë ose harruar telefonin dhe, duke dyshuar në përgjigjen e një gruaje, punonjëse e agjencisë, se nuk e kishte lënë telefonin aty, ka ngritur dyshime se kjo shtetase mund t’i kishte marrë telefonin; (iii) nisur nga tërësia e materialit të administruar rezulton se mungon ana objektive dhe subjektive e kryerjes së veprës penale si elemente të figurës së veprës penale, parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal. Vetë kallëzuesi deklaroi se ka përshtuar një farë rruge deri kur ka konstatuar që telefonin nuk e kishte me vete dhe se mund t’i kishte humbur. Në këto kushte, nisur edhe nga praktika e konsoliduar tashmë në Prokurori për rastet e humbjes së telefonit, subjekti i rivlerësimit ka proceduar me mosfillimin e procedimit penal, konform nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale. Ky vendim i është njoftuar kallëzuesit me shkresën datë 23.6.2015 dhe ky shtetas nuk ka ushtruar ankim, siç provohet nga shkresa nr. *** prot., datë 17.10.2023, e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, bashkëlidhur prapësimeve.

Vlerësimi i Komisionit

12.6 Komisioni, pasi shqyrtoi dosjen e këtij kallëzimi penal, vëren se kjo dosje përmban vetëm: vendimin datë 17.6.2015 të subjektit të rivlerësimit për mosfillimin e hetimeve; formularin datë 2.6.2015 të nënshkruar nga zëvendës drejtuesi i prokurorisë për trajtimin e materialit kallëzues; shkresën nr. *** prot., datë 2.6.2015, të Komisarariatit të Policisë Durrës për dërgimin e materialeve

¹⁰⁷ Për detaje shihni fashikullin penal në dosjen e aftësive profesionale.

pranë Prokurorisë së Rrethit Durrës; informacionin datë 1.6.2015 për referimin e veprës penale; procesverbalin datë 28.5.2015 për kallëzimin e veprës penale nga shtetasi E. S.; procesverbalin datë 16.6.2015 për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijëni për veprën penale, B. K.; relacionin datë 17.6.2015 për përfundimin e hetimeve.

12.7 Nga përmbajtja e këtyre akteve provohen rrethanat që ka shpjeguar subjekti i rivlerësimit në prapësimet e saj në lidhje me barrën e provës që i ka kaluar Komisioni, por, nga ana tjetër, nga këto akte rezulton se në zyrën e agjencisë, ku kallëzuesi dyshon se i ka humbur celulari, kanë qenë prezent edhe tre shtetas të tjerë, të cilët nuk rezulton të jenë pyetur për rrethanat e ngjarjes.

12.8 Konstatohet se nuk është pyetur më në prokurori shtetasja B. K., nuk janë kryer as veprime të tjera hetimore, si: pyetja e personave që kanë qenë prezent në zyrën doganore; sekuestrimi i kamerave në atë zyrë; marrja e të dhënave nga shoqëritë celulare, që mund të përcaktonin vendndodhjen e celularit në momentin kur humbi apo edhe më pas.

12.9 Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit në lidhje me këtë çështje nuk ka kryer veprime të plota hetimore në përputhje me nenin 24 të Kodit të Procedurës Penale, duke disponuar në rrugën më të shkurtër, me vendim mosfillimi të hetimeve.

13. Dosja nr. 3 – Procedimi penal nr. ***/2016 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, regjistruar për veprën penale “Trafikimi i mjeteve motorike” (neni 141/a/1 i Kodit Penal), përfunduar me “Vendim për pushimin e procedimit penal”, datë 23.5.2016

13.1 Procedimi penal është dërguar për kompetencë tokësore nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Nga shqyrtimi i akteve ka rezultuar se Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor Tiranë ka konstatuar se ciklomotori tip “Suzuki”, me targë ***, me nr. shasie ***, ishte denoncuar si i vjedhur në Itali, në datën 19.9.2005. Ky mjet ishte futur nga pika e kalimit kufitar Durrës në datën 10.4.2006 nga I. V., i cili kishte paguar detyrimin doganor në datën 15.5.2006, sipas vërtetimit doganor nr. ***.

13.2 Nga këqyrja e akteve në Degën e Doganës Durrës ka rezultuar se në datën 10.4.2016 nuk kishte asnjë mjet të regjistruar me nr. ***, për të cilin të ishte lëshuar vërtetimi i hyrjes, duke provuar falsitetin e këtij dokumenti, ndërsa procedurat e zhdoganimit ishin kryer në rregull, pasi rezultonte procedura për mjetin tip “Suzuki”, me nr. shasie ***.

13.3 Në analizë të provave të administruara, subjekti i rivlerësimit ka konkluduar se kishte të bënte me konsumim të elementeve të dy veprave penale “Trafikimi i mjeteve motorike” dhe “Falsifikimi i dokumenteve” (nenet 141/a/1 dhe 186 të Kodit Penal). Duke iu referuar masës së dënimit që parashikohej për këto vepra penale, që ishte në maksimumin deri në 7 vjet burgim, si dhe referuar nenit 66/b të Kodit Penal “...nuk mund të bëhet ndjekje penale kur nga kryerja e veprës deri në çastin e marrjes së personit si i pandehur kanë kaluar... dhjetë vjet për krime që parashikojnë dënim nga pesë deri në dhjetë vjet burgim”, subjekti i rivlerësimit ka konkluduar se ndjekja penale për veprat e parashikuara nga nenet 141/a/1 dhe 186 të Kodit Penal ishte parashkuar. Mbi bazën e këtij arsyetimi ligjor e referuar neneve 328/1, shkronja “d” e 329 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti ka vendosur pushimin e procedimit penal në datën 23.5.2016, duke njoftuar personat e interesuar dhe duke u shprehur për provat materiale.

- Komisioni arriti në përfundimin se nuk ka problematika në lidhje me këtë dosje.

14. Dosja nr. 4 – Procedimi penal nr. ***/2016 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, i regjistruar për veprën penale “Vjedhja” (neni 134 i Kodit Penal), përfunduar me “Vendim për pushimin e procedimit penal”, datë 10.9.2016

14.1 Nga shqyrtimi i akteve rezultoi se policia gjyqësore ka referuar aktet për vjedhjen e mjetit tip “Fiat Punto”, me targë ***, pronë e shtetasit S. Xh.. Nga veprimet hetimore ka rezultuar se shtetasi S. Xh. kishte parkuar automjetin e tij pranë Spitalit *** rreth orës 19:00 dhe ishte futur në një qendër interneti. Pas disa minutash, pronari i kësaj qendre e ka pyetur se kujt ia kishte dhënë mjetin, pasi kishte parë një djalë të ri duke drejtuar mjetin e duke u larguar drejt Lagjes nr. ***, Durrës. Shtetasi S. Xh. ka kallëzuar menjëherë në polici për vjedhjen e mjetit të tij.

14.2 Pas regjistrimit të procedimit penal, në datën 10.7.2016 është paraqitur shtetasi S. Xh., që ka deklaruar se ishte kontaktuar nga shtetasi L. A., i cili i ka shpjeguar se makinën e S. e kishte marrë gabimisht T. Gj., teknik servisi, për ta çuar në servis, duke përdorur çelësin e makinës së L., e cila ishte identike me makinën e S. dhe e kishte parkuar ngjitur me makinën e këtij të fundit. Të njëjtat rrethana ka shpjeguar edhe shtetasi T. Gj..

14.3 Në analizë të provave të administruara, prokurorja ka konkluduar se në rastin konkret nuk kishte të bënte me konsumim të elementeve të veprës penale, të parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal, por me një lajthitje në objekt nga ana e shtetasit T. Gj., i cili duke pasur si qëllim riparimin e mjetit, e kishte ngatërruar mjetin për shkak të karakteristikave të ngjashme, duke marrë mjetin e kallëzuesit. Bazuar në nenet 328/1, shkronja “b” e Kodit të Procedurës Penale, subjekti i rivlerësimit ka vendosur në datën 10.9.2016 pushimin e procedimit penal, duke njoftuar personat e interesuar.

- Komisioni arriti në përfundimin se nuk ka problematika në lidhje me këtë dosje.

15. Dosja nr. 5 – Procedimi penal nr. ***/2014 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, regjistruar për veprën penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit” (neni 278/3 i Kodit Penal) në ngarkim të të pandehurit I. B. Akti ligjor “Kërkesë për gjykimin e çështjes penale”, datë 26.12.2014.

15.1 Nga shqyrtimi i akteve ka rezultuar se në datën 26.11.2014, Salla Operative Durrës kishte marrë njoftim që i pandehuri I. B., banues në ***, po qëllonte me automatik. Punonjësit e policisë kanë mbërritur në banesën e të pandehurit dhe gjatë kontrollit kanë gjetur brenda një bidoni plastik 200 litra një armë zjarri automatike, me një krehër të vendosur në të me 15 fishekë.

15.2 Nga hetimi ka rezultuar se ky shtetas mbante armë zjarri luftarake në banesë, pa u pajisur me lejen përkatëse nga institucionet shtetërore, duke konsumuar plotësisht elementet e figurës së veprës penale, të parashikuar nga neni 278/3 i Kodit Penal. Subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin 331 të Kodit të Procedurës Penale, ka paraqitur në Gjykatë kërkesën për gjykimin e të pandehurit I. B.¹⁰⁸.

¹⁰⁸ Për detaje shihni fashikullin penal në dosjen e aftësive profesionale.

15.3 Konstatohet se bazuar në ligjin e kohës dhe në nenin 73 të ligjit nr. 96/2016, subjekti i rivlerësimit nuk ka bërë kualifikimin e duhur të veprës penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”, parashikuar nga neni 278 i Kodit të Procedurës Penale.

15.4 Vepra penale duhej kualifikuar sipas paragrafit II të nenit 278/2 të Kodit të Procedurës Penale, që parashikon: *“Mbjtja, blerja ose shitja e armëve, bombave apo minave pa lejen e organeve kompetente shtetërore dënohen me gjobë ose me burgim deri në shtatë vjet”*, duke qenë se arma e sekuestruar ishte automatike, tip “Kallashnikov” dhe, sipas aktit të ekspertimit, është armë luftarake e realizonte qitje normalisht, ndërkohë nga subjekti është bërë kualifikimi i kësaj vepre penale sipas paragrafit III të nenit 273/3, që parashikon: *“Mbjtja e fishekëve të armëve të lehta luftarake pa leje të organeve kompetente shtetërore përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit”*, duke ia lehtësuar disi pozitën të pandehurit. Në rastin konkret nuk bëhet fjalë për “armë të lehta luftarake”, por për “armë zjarri luftarake”, që realizojnë qitje.

15.5 Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit që të japë shpjegime për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

15.6 Në prapësime, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar ndryshimin e plotë që neni 278 “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit” i ligjit nr. 7895, datë 27.1.1995, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, ka pësuar me ligjin nr. 144/2013 dhe në paragrafin e tretë të nenit të ndryshuar citohet: *“Mbjtja e armëve, e bombave apo minave, ose lëndëve plasëse në automjete apo në çdo mjet tjetër të motorizuar, në mjedise publike ose në mjedise të hapura për publikun, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet”*. Po ky paragraf i këtij neni ka ndryshuar sërish me ligjin nr. 98/2014¹⁰⁹, që ka parashikuar: *“Mbjtja e armëve në banesë, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet”*.

15.7 Pra, subjekti i rivlerësimit ka bërë kualifikimin e kësaj vepre penale sipas paragrafit III të nenit 278/3, madje edhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. ***, datë 12.2.2015¹¹⁰, ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurit I. B. po sipas nenit 278/3 të Kodit Penal. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 23.2.2015.

Vlerësimi i Komisionit

15.8 Referuar llojit të armës që i është gjetur autorit të veprës penale, si dhe paragrafit të tretë të nenit 278 të ligjit nr. 98/2014, që ka qenë në fuqi në kohën kur ka ndodhur vepra penale dhe në kohën kur subjekti ka paraqitur kërkesën për gjykim, rezulton se cilësimi i veprës penale nga ana e subjektit të rivlerësimit është i drejtë në përputhje me dispozitën përkatëse të Kodit Penal, neni 278/3.

- Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se nuk konstatohen mangësi në këtë dosje.

C/4. Të dhëna nga burime arkivore lidhur me ankesa, masa disiplinore dhe vlerësime

¹⁰⁹ Ligji nr. 98/2014 ka hyrë në fuqi në gusht të vitit 2014, pra ka qenë në fuqi në datën 26.11.2014, kur ka ndodhur vepra penale.

¹¹⁰ Vendimi i depozituar nga subjekti, bashkëlidhur prapësimeve të barrës së provës.

16. Nga verifikimi i të dhënave nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, të burimeve arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme, si dhe të burimeve arkivore në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, për subjektin e rivlerësimit Anila Bebeçi rezulton se nuk janë dhënë masa disiplinore.

17. Komisioni ka administruar¹¹¹ përgjigjet e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë¹¹², që konfirmojnë se ndaj subjektit të rivlerësimit nuk është regjistruar kallëzim penal, procedim penal i filluar, i pushuar apo i mosfilluar dhe nuk ka të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo të dhëna që cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit.

18. AKSIK-ja konfirmon¹¹³ se autoritetet verifikuese/ligjzbatuese nuk kanë ndarë informacion me Prokurorinë e Përgjithshme në lidhje me subjektin e rivlerësimit.

19. Referuar raportit të KLP-së, citohet se mbi bazën e kërkesës për informacion, dërguar nga Komisioni, u është kërkuar informacion strukturave përkatëse të Prokurorisë së Përgjithshme dhe të gjitha prokurorive pranë shkallës së parë dhe janë administruar përgjigjet e shkresave, ku ka rezultuar se:

- Është regjistruar praktika nr. ***/2018 mbi bazën e ankesës së shtetasit M. S.. Ankuesi ka shfaqur pakënaqësi në lidhje me hetimet e prokurores Anila Bebeçi, kryer ndaj të pandehurit L. L., si dhe me qëndrimin në gjykim të gjyqtarës së çështjes, duke ngritur pretendime për masën e dënimit me kusht të dhënë për të pandehurin. Prokuroria e Përgjithshme ka sqaruar ankuesin se kompetente për të shqyrtuar vendimmarrjen e prokurorit është gjykata. Në rastin konkret, çështja ishte ende në shqyrtim nga Gjykata. Praktika rezultoi të jetë arkivuar.

DENONCIME

20. Pranë Komisionit janë depozituar 4 denoncime nga dy shtetas, si më poshtë:

20.1 Denoncimet nr. *, datë 28.12.2017, nr. ***, datë 24.5.2018 dhe nr. ***, datë 17.5.2021, të shtetas M. Ç.** – Denoncuesja pretendon se ka bërë kallëzim penal ndaj shtetas B. M., e cila u hetua nga prokurori E. K.. Në datën 5.8.2016, shtetasja B. M. ka paraqitur kallëzim penal kundër shtetas M. Ç., së bashku me disa dokumente bashkëlidhur kallëzimit dhe, po në këtë datë, mbi bazën e këtij kallëzimi, prokurorja Anila Bebeçi regjistron procedimin penal nr. ***/2016 për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, në ngarkim të shtetas M. Ç. pa asnjë provë e pa bërë asnjë verifikim apo hetim. Në datën 1.9.2016, prokurorja Anila Bebeçi urdhëron OPGJ-në E. D. që të kryejë veprimet hetimore për pyetjen e shtetaseve M. Ç. dhe B. M., si dhe veprime të tjera hetimore deri në datën 10.10.2016. Në datën 27.9.2016, pa u kryer asnjë veprim hetimor nga ana e OPGJ-së, prokurorja Anila Bebeçi i kërkon prokurorit të rrethit bashkimin e procedimit penal të ndjekur prej saj me procedimin penal nr. ***, datë 20.6.2016, të regjistruar në ngarkim të shtetas

¹¹¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 6.4.2021, të Prokurorisë së Përgjithshme.

¹¹² Prokuroritë e rretheve gjyqësore: Tiranë nr. *** prot., datë 18.2.2021; Pogradec nr. *** prot., datë 24.2.2021; Sarandë nr. *** prot., datë 23.2.2021; Shkodër nr. *** prot., datë 24.2.2021; Lushnjë nr. *** prot., datë 23.2.2021; Mat nr. *** prot., datë 18.2.2021; Elbasan nr. *** prot., datë 1.3.2021; Fier nr. *** prot., datë 23.2.2021; Krujë nr. *** prot., datë 5.3.2021; Gjirokastrë nr. *** prot., datë 18.2.2021; Korçë nr. *** prot., datë 26.2.2021; Pukë nr. *** prot., datë 18.2.2021; Dibër nr. *** prot., datë 23.2.2021; Tropojë nr. *** prot., datë 17.2.2021; Kavajë nr. *** prot., datë 23.3.2021; Lezhë nr. *** prot., datë 23.2.2021; Vlorë nr. *** prot., datë 24.2.2021; Përmet nr. *** prot., datë 17.2.2021; Durrës nr. *** prot., datë 17.2.2021; Kukës nr. *** prot., datë 18.2.2021; Berat nr. *** prot., datë 18.2.2021; Kurbin nr. *** prot., datë 18.2.2021.

¹¹³ Shkresë nr. *** prot., datë 17.2.2021, e AKSIK-së, dërguar pranë Komisionit me shkresën e Prokurorisë së Përgjithshme nr. *** prot., datë 6.4.2021.

B. M.. Në datën 27.9.2016, prokurori i rrethit vendosi bashkimin e dy procedimeve penale në një procedim penal me nr. ***, hetimet e të cilit u ndoqën nga prokurori E. K. dhe, pas kësaj date, subjektit të rivlerësimit i është hequr kompetenca për të hetuar procedimin penal nr. ***/2016. Në datën 21.5.2017, prokurori që ndoqi procedimin penal të bashkuar vendosi pushimin e këtij procedimi.

Gjithashtu, denoncuesja pretendon se me vendimin nr. ***, datë 29.7.2020, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, ajo është rikthyer në pozicionin e punës si mësuese, ndërsa shtetasja B.M., drejtuese e gjimnazit “****”, Durrës, për shkeljet e saj në punë është penalizuar dhe larguar nga sistemi arsimor publik. Pasi u largua nga ky sistem arsimor, shtetasja B. M. u punësua zëvendës drejtore në shkollën jopublike “****”, Durrës, ku një nga aksioneret dhe drejtuese është A. R., motra e prokurores Anila Bebeçi, ndërsa B. M. është zëvendës drejtuese e shkollës.

Bashkëlidhur denoncimeve, denoncuesja ka bashkëlidhur edhe provat përkatëse.

Nga përmbajtja e urdhrin datë 5.8.2016 “Për regjistrimin e procedimit penal dhe të emrit të personit që i ngarkohet vepra penale” në ngarkim të shtetasës M. Ç., Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka cituar në mënyrë të përmbledhur vetëm rrethanat që shtetasja B. M. ka përmendur në kallëzim, si dhe ka cituar se nevojitet kryerja e veprimeve hetimore paraprake të mëtejshme, për të sqaruar rrethanat e faktit penal dhe individualizimin e përgjegjësive penale.

Referuar këtyre akteve, nga rezulton se për një vepër penale “Falsifikimi i dokumenteve”, që kërkon një këqyrje të detajuar, të kujdesshme dhe nevojën e ekspertizës grafike, veprimi i subjektit të rivlerësimit për të regjistruar emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale, menjëherë në të njëjtën datë kur është regjistruar kallëzimi ndaj këtij personi, duket të jetë i nxituar, i bazuar në hetime të paplota. Duke pasur parasysh edhe faktin tjetër se nga data 5.8.2016, kur ka regjistruar procedimin penal, deri në datën 27.9.2016, kur janë bashkuar dy procedimet penale, nr. *** dhe nr. ***, subjekti nuk ka kryer veprime hetimore, si dhe pretendimin e denoncueses se shtetasja B. M. është punësuar në shkollën ku motra e subjektit të rivlerësimit është aksionere dhe drejtuese, ngrihet dyshimi për një trajtim jo të barabartë midis palëve në proces.

Për sa më lart, në referim të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni vlerëson që: *Duket se urdhri datë 5.8.2016 i subjektit të rivlerësimit për regjistrimin e procedimit penal dhe emrit të shtetasit, të cilit i atribuohet vepra penale, M. Ç., është marrë pa kryer asnjë veprim hetimor, duke mbajtur parasysh edhe faktin se kallëzuesja B. M. është punësuar zëvendës drejtuese në shkollën ku motra e subjektit të rivlerësimit është aksionere dhe drejtor.*

Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime në lidhje me këto rrethana.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Në prapësimet e barrës së provës, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se me urdhrin datë 5.8.2016 “Për regjistrimin e procedimit penal dhe emrit të personit që i atribuohet vepra penale” në ngarkim të shtetasës M. Ç., ka cituar në mënyrë të përmbledhur të dhënat apo rrethanat, mbi bazën e të cilave ishin kushtet që të regjistrohej emri i personit në ngarkim të të cilit do të zhvilloheshin hetimet, bazuar në nenin 287/1 të Kodit të Procedurës Penale. Nga tërësia e kallëzimit dhe materialit kallëzues, subjekti i rivlerësimit ka vlerësuar se kallëzimi ishte i detajuar, kishte

indicie për regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale, pasi kishte fotokopje të fletëve të regjistrit, që pretendoheshin të falsifikuara dhe falsifikimi i këtyre fletëve sipas kallëzuesit i atribuohet shtetases M. Ç.. Në këto kushte ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal dhe të emrit të personit, të cilit i atribuohet vepra penale e parashikuar nga neni 186/3 i Kodit Penal.

Për sa i përket punësimit të shtetases B. M. në shkollën ku motra e subjektit të rivlerësimit është aksionere dhe drejtuese, subjekti ka marrë dijeni për këtë fakt vetëm në momentin që është njohur me raportin e vlerësimit nga Komisioni.

Pretendimi i shtetases M. Ç. se kallëzuesja B. M. është punësuar zëvendësdrejtuese në shkollën ku motra e subjektit është aksionere dhe drejtore nuk qëndron, sepse subjekti jo vetëm që nuk ka pasur asnjë njohje me këtë shtetase, por referuar të dhënave nga kjo shkollë, shtetasja B. M. është punësuar aty në datën 24.9.2020, pra 4 vjet më vonë nga data e regjistrimit të procedimit penal.

Vlerësimi i Komisionit

Në lidhje me regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale, Komisioni vëren se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse, duke u bazuar në pretendimet e dyshimet e kallëzueses dhe se nuk ka kryer më parë asnjë hetim nga ana e saj, përpara se të regjistronte emrin e personit M. Ç..

Komisioni merr në konsideratë vërtetimin datë 17.10.2023 nga shkolla jopublike “***”, që konfirmon se shtetasja B. M. është emëruar si mësuese definitive pranë kësaj shkolle në datën 14.9.2020. Për këtë arsye nuk e vlerëson si favorizim të kësaj shtetaseje apo konflikt interesi me të regjistrimin e emrit të shtetases M. Ç. si person që i atribuohet vepra penale.

Për sa më lart, Komisioni arrin në përfundimin se në referim të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, subjekti i rivlerësimit ka nxjerrë urdhrin datë 5.8.2016 për regjistrimin e procedimit penal dhe emrin e shtetasit të cilit i atribuohet vepra penale, M. Ç., pa kryer asnjë veprim hetimor.

20.2 Denoncim nr. *, datë 19.10.2018, i shtetasit M. S.** – Në denoncim, denoncuesi pretendon se prokurorja Anila Bebeçi nuk ka përmendur në konkluzionet përfundimtare faktin që vajza e tij në datën 1.2.2018, kur është ushtruar dhuna e fundit ndaj saj, ka qenë shtatzënë në muajin e pestë. Vajza e tij është pyetur vetëm një herë për rrethanat e çështjes nga OPGJ-ja. Denoncuesi i ka kërkuar disa herë takim prokurores dhe, në takimin e vetëm ku e pritë, prokurori komunikoi duke bërë titur. Gjatë takimit, denoncuesi i drejtoi disa pyetje prokurorit: 1) Pse nuk e ka njoftuar si palë të dëmtuar për zhvillimet që të jenë prezent në masat e sigurimit dhe në seancat gjyqësore?; 2) Pse bisedon 5 minuta para fillimit të seancës me të pandehurin?; 3) Pse nuk pranon provat e tjera që disponon pala e dëmtuar; 4) Pse nuk e ka njohur me aktakuzën etj.

Në kërkesën për gjykim, subjekti ka pasqyruar provat e administruara gjatë hetimit dhe ka kërkuar dërgimin e çështjes për gjykim.

Komisioni, pasi administroi¹¹⁴ dhe shqyrtoi dosjen e procedimit penal nr. ***/2018 ndaj të pandehurit L. L. për veprën penale “Dhuna në familje” (neni 130/a/4 i Kodit Penal), vëren se

¹¹⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 11.9.2023, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Rrethit Gjyqësor, drejtuar Komisionit.

procedimi penal me emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale, është regjistruar në datën 6.2.2018 dhe ka përfunduar në datën 4.5.2018, pra brenda afatit procedural 3-mujor.

Referuar kërkesës për gjykimin që subjekti i ka dërguar Gjykatës, Komisioni vëren se shtetasja E. L. në datën 1.2.2018 ka bërë kallëzim në polici se bashkëshorti i saj L. L. ushtron dhunë fizike e psikologjike ndaj saj dhe, në datën që ka bërë kallëzimin, ishte 4-muajshe shtatzënë. Në datën 29.1.2018, E. është dhunuar fizikisht nga i pandehuri në sy të vajzës së tyre të mitur, 5 vjeç. Nga akti i ekspertimit mjekoligjor, datë 1.2.2018, është konkluduar se në trupin e të dëmtuarës vërehen shenja të dhunës fizike të shkaktuara me mjet mprehës. Gjithashtu, nga ekografia, datë 12.2.2018, e administruar me procesverbalin datë 14.2.2018, ka rezultuar se e dëmtuara është 22 javë shtatzënë.

Me vendimin nr. ***, datë 22.11.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, është pranuar kërkesa e subjektit për deklarinim fajtor të të pandehurit dhe dënimin e tij me 1 vit e 6 muaj burgim; në zbatim të gjykimit të shkurtuar dënohet me 1 vit burgim. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 9.3.2020, të Gjykatës së Apelit Durrës, me ndryshimin e vetëm se ka urdhëruar pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe detyrimin që të kryejë 80 orë punë në interes publik brenda 6 muajsh.

Në lidhje me pretendimin e denoncuesit se vajza e tij është pyetur vetëm një herë për rrethanat e çështjes nga OPGJ-ja, nga dosja rezultojnë procesverbalet e datave 1.2.2018 dhe 14.2.2018 mbi marrjen në pyetje të shtetasës E. L. dhe mbi rideklarimet e saj.

Në lidhje me pretendimin e denoncuesit se subjekti i rivlerësimit nuk ka përmendur në konkluzionet përfundimtare faktin që vajza e tij E. L. në datën 1.2.2018, kur është ushtruar dhuna e fundit ndaj saj, ka qenë shtatzënë në muajin e pestë, Komisioni vëren se nga aktet “Kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq” dhe “Konkluzionet përfundimtare në gjykim” subjekti i rivlerësimit ka cituar faktin që viktima E. L. në datën e ushtrimit të dhunës nga bashkëshorti i saj ka qenë 22 javë shtatzënë, referuar ekografisë së administruar në dosje.

Në lidhje me pretendimin e denoncuesit se subjekti i rivlerësimit nuk e ka njoftuar si palë të dëmtuar për zhvillimet, me qëllim që të ishte prezent në masat e sigurimit ndaj të pandehurit dhe në seancat gjyqësore, Komisioni vlerëson se bazuar në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, është kompetencë e gjykatës që të njoftojë palët për seancat gjyqësore të çdolloj gjykimi dhe jo e prokurorit. Pavarësisht nga kjo, bazuar në nenin 58, pika 1/e e Kodit të Procedurës Penale, viktima duhet të informohet për arrestimin e të akuzuarit dhe lirimin e tij në kushtet e caktuara në këtë Kod, por Komisioni vëren se arrestimi dhe caktimi i masës së sigurimit ndaj të pandehurit është kërkuar nga një prokuror tjetër, i cili është zëvendësuar më pas nga prokurorja Anila Bebeçi sipas vendimit datë 21.2.2018 të drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Durrës. Gjithashtu, në referim të nenit 279/1 të Kodit të Procedurës Penale, njoftimi i viktimës për gjendjen e procedimit dhe vendosjen e masave të sigurimit realizohet nga Prokuroria në bazë të kërkesës me shkrim të viktimës, por në dosje nuk rezulton asnjë kërkesë e tillë.

Në lidhje me pretendimet e denoncuesit se subjekti i rivlerësimit nuk i pranon provat e tjera që disponon pala e dëmtuar, Komisioni, referuar dosjes së administruar dhe akteve që ka depozituar denoncuesi, vëren se ai nuk ka paraqitur ndonjë dokument të shkruar për të provuar se i ka depozituar në prokurori provat e tjera.

Në lidhje me pretendimin e denoncuesit se i ka kërkuar disa herë takim subjektit dhe në takimin e vetëm ku e priti, ajo komunikoi vetëm duke bërë titur e duke refuzuar provat e tjera, sepse do të dërgonte dosjen në gjykatë në gjendjen që ishin aktet, si dhe në lidhje me pretendimin se subjekti i rivlerësimit ka biseduar 5 minuta para fillimit të seancës, Komisioni vëren se këto pretendime nuk provohen dhe mbeten në kuadër deklarativ. Për këto arsye, pretendimet e denoncuesit si më lart nuk provohen.

Në lidhje me pretendimin e denoncuesit se subjekti nuk e ka njohur me aktakuzën, Komisioni vëren se referuar shkresës përcjellëse nr. *** prot., datë 15.5.2018, të dëmtuarës E. L. i është njoftuar vetëm kërkesa për gjykim. Vendimi datë 19.4.2018 “Për marrjen si të pandehur dhe njoftimin e akuzës” dhe shkresa “Njoftim për përfundimin e hetimeve”, datë 19.4.2018, rezultojnë se i është komunikuar vetëm të pandehurit dhe avokatit të tij mbrojtës në datën 19.4.2018. Në zbatim të nenit 327 të Kodit të Procedurës Penale, prokurori ka detyrimin që të njoftojë mbi përfundimin e hetimeve paraprake të pandehurin, mbrojtësin e tij, si dhe viktimën, kur identiteti dhe vendbanimi i tyre rezultojnë nga aktet e procedimit.

Për sa më lart duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka zbatuar nenin 327 të Kodit të Procedurës Penale, pasi nuk ka njoftuar viktimën mbi përfundimin e hetimeve paraprake.

Komisioni i ka ngarkuar subjektin të rivlerësimit barrën e provës, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me barrën e provës

Në lidhje me barrën e provës që Komisioni i ka ngarkuar, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se, pasi ka administruar të dhënat nga sistemi TIMS, ka rezultuar se shtetasja E. L. ndodhej jashtë shtetit, por pavarësisht nga ky fakt, i ka dërguar me postë zyrtare kërkesën për dërgimin e çështjes për gjykim.

Vlerësimi i Komisionit

Komisioni vëren se shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit nuk janë bindëse, sepse njoftimi mbi përfundimin e hetimeve paraprake mund t'i bëhej edhe sipas mënyrave të parashikuara nga nenet 137-140 të Kodit të Procedurës Penale. Fakti i largimit të së dëmtuarës jashtë shtetit nuk është vlerësuar njësoj nga subjekti i rivlerësimit si shkak për mosnjoftimin e akuzës, siç ka ndodhur në rastin kur ajo i ka njoftuar me postë zyrtare kërkesën për gjykim. Për këto arsye, Komisioni vlerëson të mos e pranojë këtë prapësim të subjektit të rivlerësimit në lidhje me barrën e provës.

Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka zbatuar nenin 327 të Kodit të Procedurës Penale, pasi nuk ka njoftuar viktimën mbi përfundimin e hetimeve paraprake.

Konkluzion për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

21. Në përmbledhje të konkluzioneve, referuar raportit të hartuar nga Grupi i Punës në KLP dhe dokumentacionit bashkëlidhur, si dhe dokumentacionit të administruar nga Komisioni, trupi gjykues vlerëson se nuk janë konstatuar shkelje nga ana e subjektit të rivlerësimit deri në atë nivel që mund të çonin në konstatimin e mungesës së aftësive profesionale dhe, për rrjedhojë, bazuar në

shkronjën “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale të kërkuar nga ky ligj.

VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES NGA TRUPI GJYKUES

22. Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, referuar neneve Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës, krerëve V, VI dhe VII të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, figurës dhe të aftësive profesionale, bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, bindjen e brendshme, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti, e cila në përfundim të hetimit dhe në seancë dëgjimore, pretendoi se:

- i. Ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë sipas nenit 59/a të ligjit nr. 84/2016.
- ii. Ka arritur nivel të besueshëm për kontrollin e figurës sipas nenit 59/b të ligjit nr. 84/2016.
- iii. Ka arritur nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 59/c të ligjit nr. 84/2016 dhe kërkoi konfirmimin në detyrë.

22.1 Komisioni konkludoi për subjektin e rivlerësimit Anila Bebeçi se:

- a. Lidhur me kriterin e pasurisë rezultoi se me të ardhurat e fituara subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të/bashkëshorti kanë mungesë burimesh financiare në momentin e krijimit të pasurive në shumën -1,593,364 lekë për kryerjen e investimeve dhe të shpenzimeve të deklaruara.

Komisioni, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, i udhëhequr nga parimi i objektivitetit dhe proporcionalitetit, vlerëson se mungesa e burimeve të ligjshme nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur për të justifikuar shpenzimet dhe krijimin e pasurive, nuk ndikojnë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit dhe nuk përbën shkak të mjaftueshëm për aplikimin e masës disiplinore të shkarkimit të subjektit të rivlerësimit, sipas pikës 1 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

- b. Lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës rezultoi se subjekti i rivlerësimit, referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 59, pika “b” e ligjit nr. 84/2016, ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.
- c. Lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është “i aftë”, duke arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u

mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të pikës 1/a të nenit 58, të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Anila Bebeçi, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohej pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 26.10.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Valbona SANXHAKTARI

Kryesuese

Olsi KOMICI

Relator

Firdes SHULI

Anëtare

Sekretare gjyqësore
Resilda Bilaj